



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Përmirësimi i Kërkimit Shkencor përmes Mekanizmave të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë

Analizë Tematike

Prishtinë, 2025

Analizë Tematike

Përmirësimi i Kërkimit Shkencor përmes Mekanizmave të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë

Autorët:

*Milot Hasangjekaj
Shkelzen Gerxhaliu*

Kontribues të tjerë:

*Kastriot Ilazi
Elza Merovci
Leona Barbatovci*

Agjencia e Kosovës për Akreditim, 2025



Përmbajtja

.....	1
Përmbledhje Kryesore	5
Konteksti dhe Qëllimi	5
Metodologjia	5
Gjetjet Kryesore	6
Rekomandimet	8
Përfundim	10
Konteksti dhe Arsyetimi	12
Qëllimi	14
Metodologjia	16
Zhvillimi i Mekanizmave të Sigurimit të Cilësisë në Raport me Kërkimin Shkencor në Arsimin e Lartë në Kosovë: Praktikat dhe Analiza Krahasuese	20
Analiza Krahasuese e Vlerësimit të Fushës së Standardit të “Kërkimit Shkencor”	23
Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL-Pu1– BSc ...	24
Krahasimi i Rekomandimeve të Ekspertëve IAL Pu1 – BSc	27
Analizë Krahasuese e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL Pu1 – MSc	28
Krahasimi i Rekomandimeve të Ekspertëve IAL Pu1 – MSc	30
Analizë Krahasuese e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit, Akreditimi Institucional – IAL-Pu1	32
Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL Pr2, BSc	36
Krahasimi i Rekomandimeve të Ekspertëve – IAL-Pr2, BSc	39
Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL-Pr2, MSc	41
Analizë Krahasuese e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit, Akreditimi Institucional – IAL-Pr2	46
Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL Pu3, BA	50

Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit — IAL Pu3 MSc ..	53
Analizë Krahase e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit, Akreditimi Institucional – IAL-Pu3.....	56
Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL-Pr4, BSc.....	59
Analizë Krahase e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit IAL Pr4– MSc	62
Analizë Krahase e Fushës së Standardit të Kërkimit – Akreditim Institucional IAL Pr4	65
Analiza e Publikimeve Shkencore në IAL	74
Fushat shkencore të publikimeve	77
Analizë mbi Strategjitë, Rregulloret dhe Mekanizmat Mbështetës për Kërkimin Shkencor në IAL-të në Kosovë.....	78
Ndikimi i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë nga AKA në Institucionet e Arsimit të Lartë	79
Ndikimi i Vlerësimit të Jashtëm në Kërkimin Shkencor.....	80
Sfidat Kryesore në Zhvillimin e Kërkimit Shkencor	81
Nevoja për Mbështetje dhe Ndërhyrje Institucionale.....	81
Përfundime.....	83
Konsistenca me Kalimin e Kohës dhe Zhvillimi i Vlerësimeve ..	84
Roli dhe Përmbajtja e Rekomandimeve nga AKA.....	84
Perceptimi i IAL-ve dhe Roli i AKA-së	85
Aneksi 1: Korniza Metodologjike dhe Shkalla e Përputhshmërisë	87
Aneksi 2: Fusha e Standardit për Kërkim Shkencor në Nivel Programor dhe Institucional.....	88
Aneksi 3: Modeli i Pyetësorit për IAL-të.....	91

Përmbledhje Kryesore

Titulli: Përmirësimi i Kërkimit Shkencor përmes Mekanizmave të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë

Agjencia e Kosovës për Akreditim – Analizë Tematike, 2025

Konteksti dhe Qëllimi

Gjatë dy dekadave të fundit, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë ka përjetuar transformime të konsiderueshme, veçanërisht në zhvillimin e mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG). Brenda këtij kuadri, kërkimi shkencor është bërë gjithnjë e më shumë një fokus i vlerësimit, jo vetëm në nivel programi, por edhe në nivel institucional.

Kjo analizë tematike synon të vlerësojë ndikimin real të mekanizmave të jashtëm të sigurimit të cilësisë, të zbatuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) në zhvillimin dhe forcimin e kërkimit shkencor në të gjitha institucionet e arsimit të lartë (IAL). Analiza shkon përtej pajtueshmërisë formale dhe synon të kuptojë se si proceset e jashtme të sigurimit të cilësisë ndikojnë në strategjitë e kërkimit shkencor, produktivitetin e stafit, angazhimin e studentëve, numrin e publikimeve dhe strukturat mbështetëse institucionale.

Metodologjia

Studimi përdor një qasje të kombinuar metodologjike, që përfshin:

Analizën e dokumenteve:

- Shqyrtim i mbi 60 raporteve të akreditimit dhe ri-akreditimit (2019–2024) për programet Bachelor (BSc), Master (MSc), si

dhe vlerësime institucionale, për një mostër përfaqësuese të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë.

Anketën kuantitative:

- Një pyetësor i strukturuar i dërguar 16 IAL-ve mblodhi të dhëna mbi trendet e publikimeve, financimin, angazhimin e stafit, platformat e përdorura për publikim dhe mekanizmat mbështetës institucionale.

Metodologjia e dyfishtë lejon analiza krahasuese dhe të trendit, duke vlerësuar qëndrueshmërinë e zbatimit të standardeve të AKA-së dhe efektivitetin e tyre në nxitjen e një kulture të orientuar drejt kërkimit shkencor.

Gjetjet Kryesore

1. Integrimi i Kërkimit shkencor Ndryshon Sipas Nivelit

Programet MSc shfaqën nivelin më të lartë të përputhshmërisë me fushën e Standardit¹ të Kërkimit shkencor, me përmirësime të dukshme midis dy cikleve të vlerësimit, duke u bazuar në Raportin e Vetëvlerësimit, rregulloret e brendshme, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe planet e strukturuar të kërkimit shkencor. Programet BSc shpesh qëndruan pjesërisht në përputhshmëri, me sfida në numrin e publikimeve dhe integrimin e kërkimit shkencor në procesin mësimor. Vlerësimet dhe rivlerësimet në nivel institucional nxorën në pah çështje sistemike si mungesa e buxhetimit të dedikuar për kërkim shkencor, infrastruktura e pa zhvilluar dhe strategjitë e fragmentuara.

¹ Shih Aneksin 2: Fusha e Standardit të Kërkimit në Nivel Programor dhe Institucional

2. Boshllëqet dhe Mospërputhjet në Vlerësim

U vunë re ndryshime në vlerësimet e përputhshmërisë të të gjitha programeve të përfshira në këtë analizë ndërmjet dy cikleve të akreditimit, shpesh për shkak të dokumentacionit të paqëndrueshëm institucional ose ndryshimeve të vazhdueshme të pritshmërive nga grupi i ekspertëve. Institucionet apo programet e njëjta kanë marrë ndonjëherë rekomandime të ndryshme ndërmjet cikleve, gjë që tregon nevojën për një kornizë më të harmonizuar vlerësimi.

3. Ndikimi pozitiv i rekomandimeve të AKA-së

Të gjitha institucionet e anketuara raportuan se rekomandimet e AKA-së ishin të dobishme, dhe shumë prej tyre kanë ndërmarrë hapa konkretë si:

- Krijimi i njësive (zyreve) të kërkimit shkencor;
- Instalimi i softuerëve kundër plagjiaturës;
- Ndarja e fondeve për publikime;
- Nxitja e pjesëmarrjes së studentëve në kërkime shkencore.

4. Rritja e prodhimit shkencor, por progresi ndryshon

Numri total i publikimeve shkencore është rritur në mënyrë të qëndrueshme nga viti 2021 deri në 2024, veçanërisht në revista të indeksuara si SCOPUS dhe Web of Science. Megjithatë, mbeten dallime të mëdha midis institucioneve në aspektin e financimit, kapacitetit të stafit dhe qasjes në bazat e të dhënave.

5. Sfida sistemike

Pengesat kryesore përfshijnë:

- Mungesën e fondeve për kërkim shkencor;
- Qasjen e pamjaftueshme në revista dhe platforma dixhitale;

- Investime të ulëta në zhvillimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës kërkimore.

Rekomandimet

1. Të rishikohen metodologjia/udhëzimet e vlerësimit për fushën e Standardit të Kërkimit Shkencor

Duhet të vendoset një qasje e unifikuar dhe e qëndrueshme për vlerësimin e Fushës së Standardit të Kërkimit Shkencor në të gjitha nivelet: Bachelor, Master dhe institucional. Duhet të zhvillohet një kuadër i përbashkët monitorimi që përdor tregues të përbashkët dhe siguron koherencë vertikale mes politikave institucionale dhe zbatimit në nivel programi. Kjo do të lejonte një krahasim më të saktë, do të zvogëlonte interpretimin subjektiv dhe do të mbështeste vlerësime më të drejta dhe më të krahasueshme.

2. Të forcohet dhe institucionalizohet procesi i ndjekjes së rekomandimeve

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka filluar një proces përcjellës të rekomandimeve të panelit të ekspertëve duke filluar nga viti 2024, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt sigurimit të llogaridhënies pas akreditimit. Megjithatë, ky proces është ende në fazat e hershme dhe kërkon zbatim më të gjerë, konsistencë më të madhe dhe integrim formal në ciklet raportuese institucionale. Për të përforcuar këtë dinamikë, AKA duhet të:

- Kërkojë që të gjitha institucionet e akredituara të raportojnë sistematikisht për zbatimin e rekomandimeve, si në nivel programor ashtu edhe në nivel institucional;
- Integrojë raportimin përcjellës në raportet vjetore të cilësisë ose në mekanizmat e përcaktuar për rishikim gjysmë-cikli;

- Përdorë këto të dhëna për të informuar vendimmarrjen e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) dhe ciklet e ardhshme të vlerësimit.

3. Të forcohet mbështetja institucionale

Duhet të inkurajohet krijimi i zyrave të kërkimit shkencor, të ofrohen skema të strukturuar financimi për kërkim shkencor dhe të promovohen bashkëpunimet ndërkombëtare. Shumë institucione ende nuk kanë njësitë e dedikuara për kërkim shkencor ose struktura funksionale mbështetëse për menaxhimin e granteve, gjurmimin e publikimeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Për ta adresuar këtë, panelet e vlerësimit duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi jo vetëm ekzistencës së politikave, por edhe funksionalitetit dhe rezultateve reale të zyrave të kërkimit. Akreditimi duhet të shpërblejë institucionet që dëshmojnë:

- Pronësi të qartë institucionale të kërkimit shkencor (staf të dedikuar, linja buxhetore, përgjegjësi);
- Mekanizma efektivë për menaxhimin e granteve të brendshme;
- Partneritete ndërkombëtare që rezultojnë në publikime ose financim projektsh;

4. Të përmirësohet transparenca e të dhënave dhe dokumentimi në raportimin e kërkimit shkencor

Një problem i përsëritur është dokumentimi jo konsistent dhe i paplotë i aktiviteteve kërkimore në raportet e akreditimit dhe ri-akreditimit. AKA duhet të mbështesë zhvillimin e sistemeve institucionale të informacionit për kërkim shkencor, platformave dixhitale ku stafi akademik dhe njësitë kërkimore mund të ngarkojnë dhe përditësojnë rezultatet e tyre (publikimet, projektet, bashkëpunimet). Këto platforma do të:

- Përmirësonin cilësinë e të dhënave dhe transparencën gjatë vlerësimeve;
- Reduktonin varësinë nga të dhënat e mbledhura manualisht ose CV-të e paplota;
- Ndihmonin institucionet të monitoronin dhe analizonin progresin e tyre drejt qëllimeve strategjike të kërkimit shkencor.

5. Të forcohet koordinimin i politikave institucionale

Shumë sfida me të cilat përballen IAL-të, të tilla si qasja në bazat e të dhënave ndërkombëtare, boshllëqet në financim ose kriteret e paqarta për revistat e pranura, nuk mund të zgjidhen vetëm nga institucionet. Është i nevojshëm një koordinim më i ngushtë midis AKA-së, Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHT) dhe organeve të tjera. Kjo përfshin:

- Harmonizimin e përkufizimeve të revistave të njohura dhe metrikave të ndikimit;
- Koordinimin e financimit kombëtar të kërkimit shkencor me kërkesat që lidhen me kërkimin shkencor dhe fushat e fokusit të përcaktuara në standardet e akreditimit;
- Ofrimin e udhëzimeve të përbashkëta mbi standardet etike, promovimin akademik dhe komercializimin e kërkimit shkencor.

Përfundim

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kanë bërë përparim të dukshëm në forcimin e kërkimit shkencor. Rritja e aktivitetit të publikimeve, pjesëmarrja më e madhe në platforma ndërkombëtare si SCOPUS dhe Web of Science, si dhe përmirësimi gradual i sistemeve mbështetëse të kërkimit shkencor, të gjitha këto tregojnë për ndryshime pozitive institucionale.

Paralelisht, proceset në zhvillim e sipër për sigurim të cilësisë së jashtme të prezantuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim veçanërisht integrimi i standardit të kërkimit shkencor në procedurat e akreditimit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e këtyre ndryshimeve. Praktikrat e vlerësimit të AKA-së i kanë inkurajuar institucionet të fokusohen më shumë tek rezultatet e kërkimit, cilësia dhe dukshmëria ndërkombëtare.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, progresi mbetet i brishtë. Hendeku në përputhshmëri përgjatë vlerësimeve, infrastruktura e kufizuar dhe mbështetja e kërkimit shkencor vazhdojnë të jenë sfida. Forcimi i lidhjes midis mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë dhe zhvillimit institucional të kërkimit shkencor do të jetë thelbësor për të ruajtur këto fitime dhe për të përafuar më tej Kosovën me standardet evropiane për përsosmëri në kërkim shkencor.

Seksioni I

Konteksti dhe Arsytimi

Gjatë dy dekadave të fundit, arsimit të lartë në Kosovë ka kaluar nëpër një transformim të thellë. Ky proces nuk ka qenë thjesht teknik apo administrativ, por shpesh ka reflektuar tensione të brendshme më të thella lidhur me identitetin institucional, qartësinë e misionit dhe rolin e stafit akademik në formësimin e të ardhmes së arsimit të lartë. Në fokus të këtij udhëtimi ka qenë sigurimi i cilësisë jo si një mjet kontrolli, por si një mekanizëm për ndërtimin e besimit publik, promovimin e përgjegjshmërisë dhe kultivimin e një kulture përmirësimi të vazhdueshëm në mesin e studentëve, stafit dhe vetë institucioneve.

Ndër komponentët kryesorë të cilësisë akademike, kërkimi shkencor dallohet si misioni kryesor i universiteteve dhe nxitësi kryesor i reputacionit akademik. Megjithatë, realiteti në shumë institucione të arsimit të lartë në Kosovë mbetet sfidues: mjedise kërkimore me financim të pamjaftueshëm, qasje e kufizuar në rrjetet ndërkombëtare, strategji të brendshme të fragmentuara dhe harmonizim i pamjaftueshëm midis misioneve të mësimdhënies dhe qëllimeve të kërkimit shkencor. dhe pse proceset e sigurimit të cilësisë janë forcuar, një pyetje qendrore mbetet:

Deri në çfarë mase dhe në ç'mënyrë mekanizmat e sigurimit të jashtëm të cilësisë po e mbështesin dhe po e nxisin zhvillimin e kërkimit shkencor?

Në vitet e fundit, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka përafruar procedurat e saj me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG). Brenda këtij kuadri, fusha e standardit për “Kërkim Shkencor” është shndërruar në një nga elementet më të rëndësishme si në vlerësimet institucionale, ashtu edhe në ato programore. Kjo fushë e standardit reflekton interpretimin e ESG-së që thekson lidhjen ndërmjet edukimit dhe kërkimit shkencor, duke siguruar që aktivitetet kërkimore të kontribuojnë drejtpërdrejt në cilësinë

e mësimdhënies, zhvillimin e kurrikulës dhe rezultatet e të nxënit. Ndërkohë që ESG përqendrohet në këto lidhje, qasja e AKA-së mbështetet gjithashtu në trendet më të gjera evropiane, të tilla si ato të promovuara në kuadër të Zonës Evropiane të Kërkimit shkencor dhe Procesin e Bolonjës, të cilat e pozicionojnë përsosmërinë në kërkim shkencor si një komponent integral të reformës së arsimit të lartë dhe konkurrencës ndërkombëtare.

Kjo qasje e dyfishtë i mundëson AKA-së që të përmbushë kërkesat e ESG-së, duke integruar kërkimin shkencor në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe të përfshijë standarde shtesë nga kornizat e politikave evropiane të kërkimit shkencor. Duke vepruar kështu, AKA siguron që vlerësimet institucionale dhe programore jo vetëm që vlerësojnë se si kërkimi shkencor rrit cilësinë arsimore, por edhe inkurajojnë përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për performancën, dukshmërinë dhe ndikimin e kërkimit shkencor.

Megjithatë, mbetet një boshllëk në të kuptuarit se si këto vlerësime po përthihen në përmirësime konkrete në performancën e kërkimit shkencor në nivel institucional. Prandaj ky studim synon ta adresojë pikërisht këtë boshllëk. Studimi është një analizë shumë-dimensionale që përfshin shqyrtimin e raporteve të akreditimit dhe riakreditimit, vlerësimin krahasues të standardit të Kërkimit të AKA-së siç zbatohet si në nivelin institucional ashtu edhe në atë të programit të studimit, dhe mbledhjen e të dhënave sasiore përmes një pyetësori të strukturuar. Qëllimi nuk është vetëm të vlerësohet përputhshmëria me kërkesat e AKA-së lidhur me kërkimin shkencor, por të shqyrtohet nëse mekanizmat e sigurimit të cilësisë po krijojnë kushtet, stimujt dhe strukturat e nevojshme për të zhvilluar një kulturë domethënëse kërkimore.

Rëndësia e këtij studimi rritet edhe më tej nga pritjet gjithnjë në rritje të vendosura mbi institucionet e arsimit të lartë për të prodhuar rezultate shkencore, për të marrë pjesë në bashkëpunime ndërkombëtare dhe për të kontribuar në prioritetet e zhvillimit kombëtar. Si i tillë, gjetjet e këtij studimi janë hartuar për të mbështetur jo vetëm institucionet akademike,

por edhe politikëbërësit dhe palët e interesuara që kërkojnë të forcojnë ekosistemin e kërkimit shkencor në Kosovë.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj analize është të zbulojë rolin real që mekanizmat e sigurimit të jashtëm të cilësisë luajnë në nxitjen, vlerësimin dhe forcimin e kërkimit shkencor. Kjo qasje shkon përtej asaj që është e shkruar në dokumente formale apo raporte vlerësimi dhe fokusohet në mënyrën se si këto mekanizma pasqyrohen në praktikën e përditshme akademike dhe institucionale.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se AKA ka ndërtuar sistemin e saj të vlerësimit në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG). ESG thekson në mënyrë të veçantë lidhjen ndërmjet arsimit dhe kërkimit shkencor, duke siguruar që aktivitetet kërkimore të kontribuojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe në të nxënit e studentëve. AKA e ka interpretuar dhe zgjeruar këtë qasje duke prezantuar një Standard të dedikuar për Kërkimin shkencor. Ky standard veçohet si një ndër më të rëndësishmit në kuadër të standardeve të akreditimit, me synimin për të forcuar rolin e kërkimit shkencor brenda arsimit të lartë, duke u mbështetur njëkohësisht në tendencat dhe kriteret më të gjera evropiane për ekselencën kërkimore.

Për rrjedhojë, kjo analizë fokusohet posaçërisht në mënyrën se si fusha e standardit për Kërkim Shkencor është vlerësuar gjatë procesit të rishikimit institucional dhe të programeve studimore nga AKA duke shqyrtuar procesin e vlerësimit, nivelin e përputhshmërisë, rekomandimet e dhëna, dhe më e rëndësishmja, pasojat dhe efektivitetin e këtyre vlerësimeve në përmirësimin e praktikave kërkimore brenda institucioneve të arsimit të lartë. Përmes kësaj qasjeje, analiza synon të ofrojë një kuptim realist dhe të bazuar në dëshmi për kontributin e sigurimit të jashtëm të cilësisë në zhvillimin e kërkimit shkencor – jo vetëm në teori, por në jetën reale akademike.

Fokusi i analizës është në shqyrtimin e mënyrës se si kërkimi shkencor është integruar në standardet e akreditimit nga AKA, si është interpretuar dhe zbatuar ky standard nga institucionet, dhe si është vlerësuar nga ekspertët e jashtëm në dy nivelet kryesore gjatë cikleve të akreditimit dhe reakreditimit:

1. Në nivel institucional, ku pritet që të ekzistojnë strategji, financim dhe struktura mbështetëse për kërkimin shkencor;
2. Në nivel programor, ku përmes CV-ve, publikimeve dhe aktiviteteve të tjera shkencore, stafi pasqyron angazhimin e tij kërkimor.

Për më tepër, kjo analizë ofron një krahasim të vlefshëm ndërmjet institucioneve publike dhe private, me synim të kuptuarit jo vetëm të cilësisë së rezultateve, por edhe të kapaciteteve institucionale për të ndërtuar një kulturë të orientuar drejt kërkimit shkencor.

Objektivat e kësaj analize janë:

1. Të ofrojë një përmbledhje të sistemit të sigurimit të cilësisë në Kosovë, me fokus të veçantë në mënyrën se si kërkimi shkencor është pozicionuar brenda tij;
2. Të vlerësojë se si standardet e akreditimit të AKA-së, në nivel institucional dhe programor, përfshijnë dhe pasqyrojnë kriteret që lidhen me kërkimin shkencor, dhe të shqyrtojë nëse këto standarde mbështesin apo kufizojnë zhvillimin e kërkimit shkencor, duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet nga raportet e (re)akreditimit;
3. Të ofrojë rekomandime të synuara për përmirësimin e kapaciteteve dhe performancës kërkimore në fushën e arsimit të lartë në Kosovë.

Pyetjet kyçe të kësaj analize përfshijnë:

- Cili është gjendja aktuale e sistemit të arsimit të lartë dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë në Kosovë, veçanërisht në raport me kërkimin shkencor?
- Si ka evoluar prodhimi i kërkimeve shkencore gjatë viteve të fundit?
- Në çfarë mase standardet e akreditimit institucional adresojnë në mënyrë efektive kriteret që lidhen me kërkimin shkencor, dhe si krahasohet kjo me vlerësimet në nivel programor?
- A ekzistojnë dallime të dukshme në zbatimin e standardeve kërkimore ndërmjet programeve të nivelit bachelor dhe master?

Metodologjia

Kjo analizë tematike është zhvilluar duke përdorur një qasje të kombinuar metodologjike, e cila përfshin si analizën e dokumenteve, ashtu edhe analizën kuantitative. Qëllimi i kësaj qasjeje metodologjike është të ofrojë një vlerësim të thelluar dhe gjithëpërfshirës mbi ndikimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në kërkimin shkencor brenda institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Fushëveprimi i analizës përfshin vlerësimin e kërkimit shkencor brenda kornizës më të gjerë të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë, me fokus në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2024.

1. Analiza e Dokumenteve

Si pjesë e kësaj metodologjie, është realizuar një shqyrtim i thelluar i raporteve përfundimtare të akreditimit dhe riakreditimit, duke përfshirë një përzgjedhje të gjerë dhe përfaqësuese të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve studimore në Kosovë. Analiza ka përfshirë programe të nivelit bachelor (BSc) dhe master (MSc), me gjithsej 22 programe BSc dhe 23 programe MSc të shqyrtuara në dy cikle vlerësimi — akreditimi fillestar dhe riakreditimi pasues.

Përveç vlerësimeve në nivel programor, janë analizuar në mënyrë të detajuar edhe 15 raporte të akreditimit institucional, duke përfshirë si institucione publike ashtu edhe private.

Qëllimi i analizës ishte të krahasohet mënyra se si adresohet fusha e standardit “Kërkimit shkencor” në të dy nivelet programor dhe institucional si dhe të eksplorohet si mund të ndryshoj interpretimi dhe zbatimi i këtij standardi midis këtyre niveleve dhe me kalimin e kohës. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ka mundësuar një analizë krahasuese ndërmjet institucioneve, midis vlerësimeve programore dhe atyre institucionale, si dhe ndërmjet cikleve të ndryshme të akreditimit.

Analiza është realizuar në mënyrë të qëllimshme të thelluar dhe të detajuar, me synim të identifikojë modele, trende dhe devijime në vlerësimin e kërkimit shkencor. Vëmendje e veçantë i është kushtuar:

- Vlerësimit të fushës së standardit "Kërkimi shkencor" në raportet e akreditimit dhe reakreditimit;
- Natyrës dhe fokusit të rekomandimeve të dhëna nga panelet e ekspertëve;
- Konsistencës ose variacioneve në vlerësime përgjatë cikleve të ndryshme të vlerësimit;
- Shkallës në të cilën rezultatet e vlerësimit në nivel programor përputhen me ato në nivel institucional.

Shkalla e Përputhshmërisë e Përdorur në Analizë

Vlerësimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe/ose i programeve studimore nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) bazohet në një shkallë përputhshmërie me katër nivele², si më poshtë:

- Plotësisht në përputhshmëri;
- Përputhshmëri substanciale;

² Shih Aneksin 1: Korniza Metodologjike dhe Shkalla e Përputhshmërisë

- Pjesërisht në përputhshmëri;
- Mos-përputhshmëri

Në këtë analizë tematike, krahasimi ndërmjet cikleve të akreditimit dhe reakreditimit është bazuar në mënyrën se si programet dhe institucionet janë vlerësuar në këtë shkallë për standardin e Kërkimit shkencor. Kjo lejon identifikimin e ndryshimeve në përputhshmëri, modeleve të përmirësimit apo rënies, si dhe marrëdhënien midis rekomandimeve të paneleve dhe rezultateve konkrete të arritura.

Klasifikimi i Rekomandimeve

Për të analizuar rekomandimet në një mënyrë sistematike, është zhvilluar një klasifikues i fushave të rekomandimeve përmes analizës së temave më të përsëritura që u gjetën në raportet e vlerësimit. Ky proces përfshiu identifikimin, grupimin dhe kategorizimin e rekomandimeve në fusha tematike, duke mundur një krahasim më të strukturuar midis institucioneve, programeve dhe cikleve të akreditimit. Kjo qasje siguron një pasqyrë më të thellë të çështjeve të përsëritura dhe fushave prioritare për përmirësim në praktikat lidhur me kërkimin shkencor.

2. Analiza Kuantitative e të Dhënave

Përveç analizës së dokumenteve, është zhvilluar një pyetësor i strukturuar për të mbledhur dhe përpunuar të dhëna plotësuese që nuk pasqyrohen drejtpërdrejt në raportet zyrtare të akreditimit dhe riakreditimit. Ky instrument synonte të gjeneronte të dhëna kuantitative dhe cilësore mbi gjendjen reale të kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë dhe përbën pjesën e tretë të këtij studimi.

Pyetësi³ u shpërnda në 22 institucione të arsimit të lartë në Kosovë, nga të cilat u përgjigjën 16 institucione, që përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të totalit të institucioneve në vend. Anketa u fokusua në disa fusha kryesore, duke përfshirë vëllimin dhe natyrën e publikimeve

³ Annex 3 Questioner for HEIs

shkencore, mekanizmat institucionale mbështetës, ndikimin e perceptuar të proceseve të sigurimit të cilësisë nga jashtë, si dhe sfidat dhe nevojat me të cilat përballen institucionet. Konkretisht, u mbledhën të dhëna mbi:

- Numrin e publikimeve shkencore për çdo vit akademik (2020–2024), përfshirë publikimet me bashkëautorë ndërkombëtarë, ato të mbështetura nga grantet, dhe ato të publikuara në revista me Faktor Impakti;
- Tendencat në prodhimin e publikimeve gjatë tri viteve të fundit, së bashku me faktorët që kanë ndikuar në rritje ose ngadalësim (p.sh., politikat e brendshme të kërkimit, standardet e KAA-së, përfshirja në projekte ndërkombëtare, kriteret për promovim akademik);
- Platformat ku është botuar puna akademike (p.sh., Scopus, Web of Science, Google Scholar, Academia.edu, ResearchGate);
- Përqindja e vlerësuar e publikimeve që shfaqen në revista të indeksuara;
- Fushat shkencore mbizotëruese në të cilat janë përqendruar këto publikime, etj.

Gjithashtu, pyetësi hulumtoi infrastrukturën dhe mbështetjen institucionale për kërkimin shkencor, duke përfshirë:

- Ekzistencën e strategjive të brendshme për zhvillimin e kërkimit shkencor;
- Disponueshmërinë e fondeve të dedikuara institucionale për kërkimin shkencor dhe shumat mesatare vjetore të financimit;
- Pratinë e njësive të brendshme apo këshillave për kërkim shkencor;
- Mekanizmat për inkurajimin e aktivitetit kërkimor (p.sh., stimuj, sisteme avancimi, njohje akademike).

Pjesa e katërt e pyetësit u fokusua në ndikimin e procesit të akreditimit mbi praktikat kërkimore. Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin:

- Shkallën në të cilën sigurimi i jashtëm i cilësisë (saktësisht nga Agjencia e Kosovës për Akreditim) ka ndikuar në zhvillimin e kërimit shkencor;
- Nëse raportet e akreditimit institucional ose programor përfshinin rekomandime për përmirësimin e kërimit shkencor;
- Nëse janë ndërmarrë masa konkrete në përgjigje të këtyre rekomandimeve.

Në fund, institucionet u ftuan të reflektojnë mbi sfidat kryesore që pengojnë avancimin e kërimit shkencor, si mungesa e financimit, mungesa e qasjes në revista shkencore apo mungesa e trajnimeve për kërkimin shkencor dhe të identifikojnë format specifike të mbështetjes që u nevojiten nga Agjencia e Kosovës për Akreditim ose nga aktorë të tjerë kombëtarë, për të forcuar kapacitetet e tyre kërkimore.

[Zhvillimi i Mekanizmave të Sigurimit të Cilësisë në Raport me Kërkimin Shkencor në Arsimin e Lartë në Kosovë: Praktikë dhe Analiza Krahësuese](#)

Gjatë dy dekadave të fundit, Kosova ka shënuar përparime të konsiderueshme në reformimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë. Në qendër të këtij progresi qëndron krijimi dhe konsolidimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë, veçanërisht përmes Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Me përpjekjet për t'u përafëruar me Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), proceset e brendshme dhe të jashtme të SC janë bërë më të sofistikuar dhe më me ndikim.

Kërkimi shkencor, si një funksion thelbësor i institucioneve të arsimit të lartë, luan një rol vendimtar në cilësinë akademike, zhvillimin kombëtar dhe njohjen ndërkombëtare. Megjithatë, integrimi i kërimit shkencor në kornizën e sigurimit të cilësisë së jashtme (EQA) të Kosovës është ende në proces. Ndërkohë që është bërë përparim në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe efektivitetit të proceseve administrative kundrejt kritereve të paracaktuara të akreditimit, zhvillimi i kapacitetit kërkimor brenda institucioneve has në sfida të vazhdueshme, përfshirë

infrastrukturë të kufizuar, financimi i pamjaftueshëm dhe kapacitete institucionale të paqëndrueshme.

AKA, e themeluar në vitin 2004, është institucioni kombëtar përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë. AKA funksionon si një agjenci regullative e pavarur dhe ka mandat të akreditojë IAL-të dhe programet akademike, të vlerësojë performancën institucionale dhe të promovojë një kulturë të cilësisë përmes procedurave të standardizuara dhe vlerësimeve periodike.

Procedurat e AKA-së bazohen në Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015), duke siguruar përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. AKA realizon procesin e akreditimit dhe ri-akreditimit (çdo 3–5 vjet), si dhe bën monitorime të vazhdueshme të institucioneve dhe programeve. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) përcakton standardet e akreditimit, përcakton kriteret përkatëse të vlerësimit, merr vendime për akreditimet dhe jep miratimin përfundimtar për raportet dhe rekomandimet. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë të AKA-së e parashikojnë vlerësimin e kërimit shkencor kundrejt këtyre standardeve, si në nivel institucional ashtu edhe në nivel programor.

Në nivel institucional, standardet e SC-së kërkojnë që institucionet e arsimit të lartë (IAL) të:

- Tregojnë një strategji të qartë kërkimore të përafruar me misionin dhe prioritetet kombëtare.
- Paraqesin dëshmi për angazhimin e stafit në kërkime shkencore, përfshirë pjesëmarrjen në konferenca dhe botime në revista shkencore me rishikim kolegjial.
- Mbajnë mekanizma mbështetës institucionale për kërkime (p.sh., zyra kërkimore, skema financimi, partneritete).
- Ndjekin dhe raportojnë rregullisht rezultatet kërkimore, përfshirë botime shkencore, patenta dhe projekte bashkëpunimi.

Në nivel programi, standardet për kërkime shkencore trajtohen më indirekt. Ndërsa fokusi është kryesisht në program, kualifikimet e stafit dhe rezultatet e të nxënit, pritet që stafi akademik të jetë i përfshirë në kërkime relevante në fushën e tyre. AKA përdor tregues kuantitativ dhe cilësorë për të vlerësuar kërkimin shkencor të programeve, duke përfshirë:

- Numrin e publikimeve të rishikuara nga kolegët për anëtar të stafit.
- Pjesëmarrjen në projekte të financuara.
- Disponueshmërinë e infrastrukturës dhe shërbimeve që mbështesin kërkimin shkencor.
- Politikat institucionale për të promovuar integritetin akademik dhe etikën e kërkimit shkencor.

Panelet e vlerësimit, të përbëra nga ekspertë ndërkombëtarë, vlerësojnë këta tregues gjatë procesit të akreditimit programor. Kjo analizë krahason mënyrën se si janë kryer këto vlerësime në të dy ciklet e akreditimit — akreditim dhe riakreditim — dhe analizon rezultatet e vlerësimit për të njëjtat programe që kanë kaluar të dy ciklet. Qëllimi është të identifikohen qasjet e vlerësimit, thellësia e analizës dhe rezultatet për standardet dhe tregues përkatës në secilin rast, si dhe të nxirret një përfundim mbi konsistencën e tyre.

Seksioni II

Analiza Krahasuese e Vlerësimit të Fushës së Standardit të “Kërkimit Shkencor”

Ky seksion paraqet një analizë krahasuese të mënyrës se si është vlerësuar fusha e standardit “Kërkimi shkencor” nga AKA në dy cikle të akreditimit (akreditim dhe ri-akreditim), për një grup të përzgjedhur programesh studimore si dhe të vlerësimit të standardit të “kërkimit” në lidhje me akreditimin institucional. Qëllimi kryesor është të vlerësohet qasja e përdorur nga panelet vlerësuese dhe konsistenca në interpretimin dhe zbatimin e kërkesave të standardit, në mënyrë që të identifikohen përmirësimet, mospërputhjet ose zhvillimet në praktikë.

Analiza përfshin gjithsej 21 programe studimi dhe 8 institucione të arsimit të lartë. Për secilin program dhe institucion, janë rishikuar raportet nga ciklet e akreditimit dhe ri-akreditimit, duke rezultuar në analizën e 22 raporteve për programet BSc, 23 raporteve për programet MSc, 15 raporteve institucionale dhe gjithsej 60 raporteve. Fokus i veçantë është vënë në shqyrtimin e mënyrës se si është trajtuar standardi i “Kërkimit”, me theks të veçantë në qëndrueshmërinë e vlerësimit, qasjet e përdorura nga panelet e vlerësimit dhe thellësinë e analizës gjatë cikleve, duke u fokusuar në:

- Vlerësimet për fushën e standardit të "Kërkimit" të secilit program,
- Vlerësimet për fushën e standardit të "Kërkimit" në çdo akreditim institucional,
- Përputhshmërinë me kërkesat e standardit nga programet dhe institucionet,
- Ndryshimet në komente dhe rekomandime midis dy vlerësimeve (akreditimit dhe riakreditimit),
- Qasjen e përdorur nga panelet në vlerësimin e dëshmimeve dhe dokumentacionit.

Për hir të transparencës dhe për të ruajtur një qasje neutrale dhe objektive, institucionet e arsimit të lartë të përfshira në këtë analizë janë identifikuar me kode të tilla si: HEI-Pu1, HEI-Pr2, HEI-Pu3 dhe HEI-Pr4. Shkurtesa “Pu” i referohet institucioneve publike, ndërsa “Pr” i referohet institucioneve private. Ky sistem kodimi është aplikuar për të shmangur çdo paragjykim të mundshëm dhe për të mbajtur fokusin e analizës tek përmbajtja dhe rezultatet e vlerësimeve, pa identifikuar drejtpërdrejt institucionet përkatëse.

Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL-Pu1– BSc

Kjo pjesë përmban një analizë krahasuese të vlerësimeve nga ekspertët e fushës gjatë akreditimit të programeve ndërmjet dy cikleve të akreditimit (2021 dhe 2024) në nivelin BSc të institucionit IAL-Pu1. Analiza fokusohet në Fushën e Standardit 6 (Kërkimi) dhe përfshin dallimet në vlerësim, përputhshmëri me standardin, si dhe komentet dhe rekomandimet nga panelet e ekspertëve për secilin nënstandard.

Standar di 6 Tregues it	Vlerësi mi 2021	Vlerësi mi 2024	Dallimi në përputhshm ëri	Dallimet në komente/rekomandi me
6.1	B	B	Pa ndryshim	Mungesë objektivash të qarta për programin në të dy vitet; përmendet mungesë mbështetjeje financiare dhe logjistike
6.2	B	B	Pa ndryshim	Theksohet përfshirja në dokumente, por mungojnë detaje

				dhe zbatimi mbetet i paqartë
6.3	A	A	Pa ndryshim	Rregulloret ekzistojnë në të dy vitet; pa ndryshim
6.4	B	B	Pa ndryshim	Vështirësi në verifikim të të dhënave në 2024; mungesë liste të plotë të publikimeve
6.5	A	B	Rënie	Vlerësim më i ulët në 2024 për shkak të mungesës së listës së plotë të publikimeve
6.6	B	—	Pa vlerësim të qartë	Nuk ka vlerësim të plotë në 2024; mungesë informacioni në RVV
6.7	B	C	Rënie	Rënie e ndjeshme; lista e publikimeve është e paplotë dhe e paformatuar, duke ngritur shqetësime për cilësinë
6.8	A	A	Pa ndryshim	Përputhje e plotë në të dy vitet.
6.9	B	B	Pa ndryshim	Vlerësim i bazuar në intervista; potencial

				për përmirësim mbetet.
6.10	A	A	Pa ndryshim	Në të dy vitet përmendet ligji; në 2024 përmendet edhe ndikimi i inteligjencës artificiale
6.11	B	B	Pa ndryshim	Pa evidencë të dokumentuar, por përfshirja përmendet nga studentët në të dy vitet

Tabela 1. Vlerësimi Krahasues i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit

Duke u bazuar në analizën krahasuese të standardit të kërkimit për ciklet e akreditimit të viteve 2021 dhe 2024, vërehen disa ndryshime të rëndësishme në lidhje me dokumentacionin, cilësinë e informacionit të paraqitur dhe, si pasojë, vlerësimin. Në të dy vitet theksohet mungesa e objektivave të qarta kërkimore specifike për programin, si dhe mungesa e mbështetjes financiare dhe logjistike. Megjithëse politika institucionale për përfshirjen e stafit në kërkime është e pranishme, mangësitë në zbatimin praktik dhe në dokumentimin e aktiviteteve janë të dukshme në të dy ciklet.

Në vitin 2024, është vërejtur një rënie e vlerësimit në disa tregues, veçanërisht në treguesin 6.5 dhe 6.7, për shkak të mungesës së listave të plota dhe të strukturuar të publikimeve, si dhe dyshimeve në cilësinë e burimeve të raportuara. Vlerësimi i standardit për publikimet individuale ka kaluar nga “B” në “C”, duke sinjalizuar mungesë të përmbushjes së standardit për publikime vjetore mesatare për anëtar të stafit.

Krahasimi i Rekomandimeve të Ekspertëve IAL Pu1 – BSc

Në vijim paraqitet një përmbledhje krahasuese e rekomandimeve të dhëna nga panelet e ekspertëve gjatë cikleve të akreditimit të viteve 2021 dhe 2024. Tabela identifikon fushat ku rekomandimet janë përsëritur, si dhe ato që janë shtuar rishtazi në vitin 2024. Kjo analizë ndihmon në evidentimin e progresit institucional dhe përsëritjes së dobësive që kërkojnë trajtim të qëndrueshëm.

Fusha e rekomandimit	Rekomandime 2021	Rekomandime 2024
Plane individuale të kërkimit	Po	Po
Dokumentimi i publikimeve	Jo	Po
Aftësi shkencore dhe citim	Po	Jo
Përfshirja e studentëve në kërkime	Po	Po
Përfshirja e hulumtuesve të rinj	Po	Jo
Angazhimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me industrinë	Jo	Po
Sasia minimale e publikimeve	Jo	Po

Tabela 2. Përmbledhje e Komenteve dhe Rekomandimeve të Panelit të Ekspertëve mbi Standardin e Kërkimit

Analizë Krahase e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL Pu1 – MSc

Kjo pjesë përmban një analizë krahasuese të vlerësimit të Standardit 6 gjatë procesit të akreditimit të programeve në nivelin MSc, ndërmjet dy cikleve të akreditimit (2021 dhe 2024) për të njëjtin institucion (IAL-Pu1). Analiza fokusohet në standardin e Kërkimit (6) dhe përfshin dallimet në vlerësim, përputhshmëri me standardet, si dhe komentet dhe rekomandimet nga panelet e ekspertëve për secilin nënstandard.

Tabela më poshtë përmbledh vlerësimet sipas nën standardeve, ndryshimet në përputhshmëri me standardet, si dhe komentet dhe rekomandimet e ekspertëve për secilin nën standard.

Standar di	Vlerësi mi 2021	Vlerësi mi 2024	Dallimi në përputhshm ëri	Dallimet në komente/rekomandi me
6.1	C	B	Përmirësim	Nga mungesë e qartë e objektivave dhe mbështetjes, në 2024 përmendet vetëdijesimi dhe disa përpjekje financiare, por mungojnë parashikime të qarta.
6.2	B	A	Përmirësim	Nga mungesë transparence në 2021 në perceptim pozitiv të transparencës dhe vetëdijes në 2024.

6.3	A	A	Pa ndryshim	Politikat e përcaktuara në të dy vitet.
6.4	B	A	Përmirësim	Nga evidenca të dobëta dhe CV të papërgatitura në 2021, në 2024 përmendet cilësi më e lartë dhe kërkohet klasifikim sipas faktorëve të ndikimit.
6.5	B	A	Përmirësim	Nga vlerësim i moderuar në 2021 në një prezantim të qartë të aktiviteteve shkencore në CV në 2024.
6.6	B	A	Përmirësim	Nga përmendje e përgjithshme në 2021 në fokusim të veçantë në angazhimin e FAV dhe performancë të lartë në 2024.
6.7	B	B	Pa ndryshim	Përputhje e pjesshme në të dy vitet, por në 2024 theksohet nevoja për respektim të standardit nga të gjithë.

6.8	A	A	Pa ndryshim	Standardi përmbushet në të dy vitet sipas kontrolleve në Google Scholar dhe SCOPUS.
6.9	B	A	Përmirësim	Nga potencial për përmirësim në 2021, në 2024 ekipi i ekspertëve beson se përmbajtja mësimore pasqyron kërkimet.
6.10	A	A	Pa ndryshim	E njëjta mbështetje ligjore e përmendur në të dy vitet.
6.11	B	A	Përmirësim	Nga mungesë provash në 2021 në angazhim të detyrueshëm në 2024.

Tabela 3. Vlerësimi Krahases i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit (2021-2024)

Krahاسimi i Rekomandimeve të Ekspertëve IAL Pu1 – MSc

Në ciklin e vitit 2021, rekomandimet përqendroheshin kryesisht në përmirësimin e aftësive të stafit për shkrim shkencor dhe nevojën për përfshirje më të madhe të studentëve në kërkim. Mungesa e CV-ve të strukturuar dhe mungesa e të dhënave të verifikueshme për publikime ishin ndër shqetësimet kryesore të theksuara nga paneli.

Në vitin 2024, fokusi i rekomandimeve kalon drejt forcimit të mekanizmave sistemik për zhvillimin e kërkimeve shkencore, duke përfshirë sigurimin e fondeve shtesë për programin, përmirësimin e cilësisë së prezantimit të publikimeve përmes vlerësimit me faktor ndikimi, si dhe përmbushjen e standardit të një publikimi në vit për çdo anëtar të stafit. Kjo tregon një kalim nga rekomandime operationale drejt adresimit të çështjeve strukturore dhe strategjike.

Edhe pse disa nga rekomandimet e vitit 2021 nuk përsëriten në raportet e vitit 2024, progresi i bërë nga institucioni tregon se këto rekomandime të mëparshme janë adresuar, të paktën pjesërisht. Rekomandimet e vitit 2024 janë më të qarta, të matshme dhe të orientuara drejt rezultateve, duke reflektuar zhvillim pozitiv në qasjen e institucionit ndaj kërkimit shkencor. Për me shumë shih tabelën më poshtë.

Fusha e rekomandimit	Rekomandime 2021	Rekomandime 2024
Shkrimi shkencor dhe citimi korrekt	Po	Jo
Përfshirja e studentëve në kërkime shkencore	Po	Jo
Sigurimi i fondeve për kërkim shkencor	Jo	Po
Cilësia dhe prezantimi i publikimeve	Jo	Po
Përmbushja e standardeve të publikimeve nga stafi	Jo	Po

Tabela 4. Përmbledhje e Komenteve dhe Rekomandimeve të Panelit të Ekspertëve mbi Standardin e Kërkimit (2021-2024)

Analizë Krahase e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit, Akreditimi Institucional – IAL-Pu1

Ky seksion ofron një analizë krahasuese të vlerësimit të standardit të kërkimit përgjatë periudhës së akreditimit institucional (2020–2025) dhe akreditimit të dy programeve studimore (BSc dhe MSc) në vitet 2021 dhe 2024 për institucionin IAL P1. Analiza fokusohet në nivelin e përputhshmërisë me Standardin 6, komenteve të dhëna nga ekspertët, si dhe rekomandimeve për përmirësim. Në vijim paraqitet një krahasim përmbledhës ndërmjet tri qasjeve të vlerësimit:

Fusha e vlerësimit	BSc (2021 dhe 2024)	MSc (2021 dhe 2024)	Institucional (2020–2025)
Fokusi në kërkim shkencor	I kufizuar në dëshmi të bazuara në dokumente, me materiale mbështetëse të pamjaftueshme dhe pa inventarë apo baza të dhënash të plotë; vlerësime të qëndrueshme ose në rënie në disa tregues.	Përmirësim i dukshëm në të shumtën e nënstandardeve; përpjekje për përfshirje sistemike dhe dokumentim më të mirë.	Strategji e paqartë; kërkimi i pozicionuar si prioritet por pa mbështetje reale; mungesë transparence për fonde dhe struktura administrative.
Vlerësimi përmbledhës	Pjesërisht në përputhshmëri; mangësi të	Përmirësim i përgjithshëm; kalim nga “B”	Vlerësuar si pjesërisht në përputhshmëri;

	theksuara në nën-standardet 6.5 dhe 6.7	në “A” në shumicën e nënstandardeve.	mungesë e ndarjes së qartë buxhetore, dhe mungesë treguesish të performances
Strukturat mbështetëse	Mungesë qartësie mbi mbështetjen institucionale për kërkim shkencor.	Përmendet angazhimi i IAL, së bashku me përpjekjet për strukturim më të mirë	Mungesë e zyrës për kërkime shkencore në nivel universitar; rekomandohet krijimi i një strukture mbështetëse për projekte ndërkombëtare.
Publikimet si Dëshmi e Performancës Kërkimore	Probleme me cilësinë dhe formatimin e listës së publikimeve; mungesë verifikimi.	Cilësi dhe paraqitje e përmirësuar e publikimeve; përmendet klasifikimi sipas faktorëve të ndikimit	Rritje në numrin e publikimeve ndërkombëtare, por mungesë treguesish për vlerësim vjetor për staf.
Pjesëmarrja e stafit dhe studentëve	Përmendet, por me dyshime për efektivitetin dhe mungesë dokumentimi.	Dëshmi në rritje për përfshirje të studentëve dhe hulumtuesve të rinj në aktivitetet kërkimore	Pjesëmarrja e stafit përmes rrjeteve ndërkombëtare, por perceptimi i stafit si

			“arsimor” dhe jo “kërkimor”.
--	--	--	------------------------------

Tabela 5. Krahاسimi i Përputhshmërisë dhe Komentimeve

Vlerësimi institucional jep një pamje më të gjerë dhe të thelluar të kapaciteteve kërkimore të institucionit si tërësi, duke nxjerrë në pah mangësitë sistemike: mungesën e një strategjie të qartë, të ndarjes së fondeve, dhe të strukturave të nevojshme për mbështetje. Programi MSc evidentohet me përmirësime domethënëse ndërmjet viteve 2021 dhe 2024, duke reflektuar përpjekje për rritjen e cilësisë dhe dokumentimit të aktiviteteve kërkimore. Programi BSc, në të kundërt, paraqet një stabilitet të kufizuar dhe madje disa dobësime në vlerësime, sidomos në lidhje me dokumentimin e publikimeve dhe respektimin e standardeve për produktivitetin kërkimor.

Në krahasim me vlerësimin institucional, të dy programet ndajnë sfida të përbashkëta si mungesa e objektivave të qarta kërkimore dhe mbështetjes së dokumentuar, por vlerësimi institucional shton thellësinë duke identifikuar boshllëqe në ndarjen buxhetore, në përgatitjen e stafit mbështetës dhe në përcaktimin e treguesve për vlerësim të performancës kërkimore.

Niveli i Vlerësimit	Viti 2021	Viti 2024	Vlerësimi i Përgjithshëm i Përputhshmërisë
Programi BSc	Pjesërisht në përputhshmëri	Pjesërisht në përputhshmëri, me regres në disa nënstandarde	Pjesërisht në përputhshmëri

Programi MSc	Pjesërisht në përputhshmëri	Përputhshmër i substanciale	Përputhshmëri substanciale
Institucioni	-	2020-2025 (periudha pesëvjeçare e akreditimit)	Pjesërisht në përputhshmëri

Tabela 6. Krahësimi i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit

Pogrami BSc mbetet në nivelin “pjesërisht në përputhshmëri” në të dy ciklet e akreditimit, me një tendencë të dobësimit në vitin 2024, për shkak të mungesës së dokumentimit të plotë për publikimet dhe cilësinë e dyshimtë të disa burimeve. Standardi për një publikim në vit për anëtar stafi nuk është përmbushur. Programi MSc tregon progres të konsiderueshëm nga viti 2021 në 2024, duke kaluar në nivelin “përputhshmëri substanciale”, si rezultat i një strukture më të qartë të evidencave, përmirësimeve në CV-të e stafit dhe klasifikimit të botimeve sipas faktorit të ndikimit. Vlerësimi institucional përshkruan mangësi sistematike që ndikojnë drejtpërdrejt në përputhshmërinë me standardin “Kërkimor”. Pavarësisht përmirësimeve në numrin e publikimeve ndërkombëtare, mungesa e ndarjes buxhetore për kërkim, mungesa e treguesve dhe strukturave mbështetëse rezulton në vlerësimin “pjesërisht në përputhshmëri” në nivel institucional.

Vlerësimi i standardit të kërkimit për programin MSc u vlerësua si "përputhshmëri substanciale", ndërsa i njëjti standard në nivel institucional u vlerësua si "Pjesërisht në përputhshmëri". Kjo mospërputhje tregon qartë se angazhimi dhe rezultatet e kërkimit shkencor janë më të strukturuar, më mirë të dokumentuara dhe më mirë të mbështetura në nivel programi sesa në nivel institucional. Në rastin e programit MSc, dokumentet e vetëvlerësimit dhe provat mbështetëse paraqesin një gamë aktiviteteve konkrete kërkimore, duke përfshirë

publikimet, përfshirjen e studentëve në projekte, mbështetjen financiare për kërkim shkencor dhe politika të qarta për zhvillimin akademik.

Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL Pr2, BSc

Ky seksion përmban një analizë krahasuese të vlerësimit nga ekspertët e fushës gjatë akreditimit të programit BSc në IAL-Pr2, ndërmjet cikleve të akreditimit 2022 dhe 2025. Analiza fokusohet në Standardin (6) të “Kërkimit shkencor” dhe përfshin dallimet në vlerësim, përputhshmëri me standardet, si dhe komentet dhe rekomandimet nga panelet e ekspertëve për secilin nënstandard.

Nën-standardi	Vlerësimi 2022	Vlerësimi 2025	Ndryshimi në Përputhshmëri	Dallimet në Komete/Rekomandime
6.1	C	B	Përmirësim	Nga mungesë mbështetjeje financiare dhe përfshirje e kufizuar, në 2025 evidentohet integrim i qartë me misionin dhe sigurimi i mbështetjes praktike operative, siç janë ambiente, pajisje dhe asistencë administrative për aktivitetet kërkimore.
6.2	B	A	Përmirësim	Përfshirje e vazhdueshme e stafit në kërkim shkencor me mbështetje të

				zgjeruar financiare dhe profesionale.
6.3	B	A	Përmirësim	Përmirësim i politikave institucionale dhe rritje e bashkëpunimit ndërkombëtar.
6.4	B	A	Përmirësim	Përputhje më e mirë e kërkimit shkencor me mësimdhënien; integrim i drejtpërdrejtë në kurrikulë.
6.5	C	B	Përmirësim	Publikime më të strukturuar; vërehet pjesëmarrja në konferenca, por përvoja e kufizuar në kërkime shkencore të financuara nga jashtë ose me kontrata (p.sh., projekte të financuara nga BE-ja, etj.)
6.6	C	B	Përmirësim	Prezantimi i mekanizmave të validimit dhe transferimit të teknologjisë, megjithëse kërkohet më shumë dëshmi.

6.7	C	B	Përmirësim	Rritje e publikimeve të stafit, por ende nën objektivin institucional.
6.8	A	A	Pa ndryshim	Publikime të stafit nën emrin e institucionit; përputhje e plotë.
6.9	B	A	Përmirësim	Integrim efektiv i kërkimit shkencor në mësimdhënie; konfirmuar përmes intervistave.
6.10	C	B	Përmirësim	Përmirësime në strukturat e pronës intelektuale dhe funksionimin e Qendrës së Transferimit të Teknologjisë (QTT).
6.11	B	B	Pa ndryshim	Përfshirje e moderuar e studentëve në kërkim shkencor; numër i ulët, por i pranueshëm për nivelin Bachelor.

Tabela 7. Vlerësimi Krahases i Përputhshmërisë me Standardet e Kërkimit shkencor

Krahësimi i Rekomandimeve të Ekspertëve – IAL-Pr2, BSc

Rekomandimet e dhëna gjatë ciklit të parë të vlerësimit (2022) për programin BSc kishin karakter thelbësisht korrigjues dhe dokumentues, duke u përqendruar në ndreqjen e boshllëqeve lidhur me planifikimin e fondeve kërkimore, përfaqësimin formal të stafit në projekte, dhe nevojën për struktura minimale të raportimit të publikimeve dhe profileve akademike. Në këtë fazë, qasja e ekspertëve ishte reaktive dhe synonte që institucioni të ndërtonte themelet e një kulture të kërkimit akademik dhe të përfaqësimit institucional.

Në ciklin e ri-akreditimit (2025), vlerësimi kalon në një nivel më të avancuar, duke reflektuar një rritje të kapacitetit strategjik të institucionit. Rekomandimet e vitit 2025 janë të orientuara drejt zhvillimeve të qëndrueshme dhe të ndikimit, duke përfshirë krijimin e qendrave të specializuara për kërkime, strukturimin e mekanizmave për komercializimin e kërkimit, fuqizimin e bashkëpunimit me industrinë, dhe përfshirjen sistematike të stafit të ri në procesin e avancimit akademik. Ky tranzicion tregon se institucioni ka kaluar nga një fazë ndërtimi të kapaciteteve bazë në një fazë strategjie institucionale për ekselencë kërkimore. Ndryshimi midis dy cikleve reflekton rritjen e vetëdijes institucionale për kërkimin shkencor si shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm të programit dhe të rolit të tij në tregun akademik dhe të industrisë.

Fusha rekomandimit	e	Rekomandime 2022	Rekomandime 2025
-----------------------	---	------------------	------------------

Planifikimi financiar për kërkime	Planifikim i detajuar i fondeve për kërkim – burimet, shumat dhe ndarja	Zgjerimi i pjesëmarrjes në fonde ndërkombëtare dhe rritje e mbështetjes së brendshme
Dokumentimi i projekteve dhe përfshirjes së stafit	Publikimi i listës së projekteve dhe pjesëmarrjes së stafit	Krijimi i qendrës së kërkimit për robotikë, AI dhe projekte të fokusuara
Evidenca e publikimeve	Paraqitje e përmbledhur e publikimeve të rëndësishme të 5 viteve të fundit për çdo staf	Strukturim dhe kategorizim i publikimeve për efektivitet më të lartë
Profili i stafit në platforma kërkimore	Krijimi/azhurnimi i profileve në Google Scholar për çdo staf	Mbështetje për mentorim dhe publikim në revista me faktor ndikimi
Sistemi i shpërblimit për ekselencë shkencore	Krijimi i sistemit të shpërblimit për publikime cilësore	Çmime vjetore për publikimet më të mira të stafit – nisje nga qershori 2026
Pjesëmarrja në konferenca shkencore	Inkurajimi për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare (me vëmendje ndaj kufizimeve të vizave)	Rritje e përfshirjes në ngjarje ndërkombëtare dhe konsolidim i pranisë akademike ndërkombëtare

Tabela 8. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të panelit të ekspertëve mbi fushën e standardit të Kërkimit

Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL-Pr2, MSc

Ky seksion paraqet një krahasim të detajuar të përputhshmërisë me standardet e kërkimit dhe rekomandimeve të dhëna nga ekspertët për programin Master në IAL – Pr2, bazuar në ciklet e vlerësimit të viteve 2022 dhe 2025. Krahasimi synon të evidentojë progresin, ndryshimet në qasjen ndaj kërkimit, si dhe thellimin e analizës së ekspertëve në drejtim të cilësisë së kërkimit, përfshirjes së studentëve dhe integritetit të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe industriale. Tabela e parë paraqet vlerësimin e përputhshmërisë për secilin nën-standard, ndërsa tabela e dytë pasqyron dallimet në rekomandimet e dhëna në të dy ciklet.

Standardi (Treguesit)	Vlerësim i 2022	Vlerësim i 2025	Dallimi në përputhshmë ri	Komentet / Sqarime
6.1	C	A	Përmirësim i dukshëm	Nga burime të paqarta dhe mungesë planifikimi të detajuar në 2022 në një strukturë të qartë dhe mbështetje të fortë institucionale në 2025.

6.2	B	A	Përmirësim	Nga përfshirje minimale në 2022 në mbështetje të strukturuar, fonde dhe kohë të ndarë për kërkime në 2025.
6.3	B	A	Përmirësim	Nga mungesë e politikave të qarta në përkrahje të bashkëpunimeve të gjerë ndërkombëtare dhe kombëtare.
6.4	C	B	Përmirësim	Nga mungesë aktivitetesh të lidhura me fushën në 2022, në përmirësime evidente, por jo për të gjithë stafin në 2025.
6.5	C	B	Përmirësim	Nga aktivitet i ulët publikimesh në përmirësim të prezencës në konferenca dhe revista, me

				mangësi të pjesshme.
6.6	C	B	Përmirësim	Nga mungesë e strukturave për validim në përmirësim me pjesëmarrje në projekte dhe konsulencë.
6.7	C	C	Pa ndryshim	Mbetet sfida për të gjithë stafin të arrijnë normën e 1 publikimi/vit.
6.8	B	B	Pa ndryshim	Publikimet nën emrin e institucionit mbesin në të njëjtin nivel.
6.9	B	B	Pa ndryshim	Politikat për pronësinë intelektuale ekzistojnë, por nuk janë zhvilluar plotësisht.
6.10	B	A	Përmirësim	Nga përfshirje të kufizuar të studentëve në 2022, në mbështetje të fortë për

				publikime dhe mentorim në 2025.
--	--	--	--	---------------------------------

Tabela 10. Vlerësimi Krahësues i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit

Fusha e Vlerësimit	2022	2022 – Përmbajtja	2025	2025 – Përmbajtja
Planifikimi i Financimit të Kërkimit shkencor	Po	Përmendet planifikimi, por jo në mënyrë të detajuar	Po	Kërkohej planifikim i detajuar dhe transparent për financimin e kërkimit shkencor
Publikime me Ndikim të Lartë	Po	Kërkohej mesatarisht 1 publikim në vit për çdo anëtar të stafit	Po	Caktohet numër minimal i publikimeve cilësore në vit, me kategorizim të qartë sipas faktorëve të ndikimit
Mentorimi dhe Bashkautorësia me Studentët	Po	Përmendet në terma të përgjithshëm	Po	Kërkohej krijimi i proceseve të strukturuar për mentorim dhe bashkautorësi ndërmjet studentëve dhe stafit

CV-të dhe Standardizimi i Dokumenteve	Po	Kërkohen CV të detajuara dhe të unifikuara	Jo	Nuk theksohet në vitin 2025
Mobiliteti i Stafit	Po	Kërkohet mobilitet ndërkombëtar për stafin në fillim të karrierës	Jo	Nuk theksohet në vitin 2025
Bashkëpunimet Ndërkombëtare	Po	Përmendet pa objektiva specifike	Po	Kërkohet përfshirje e gjerë në Erasmus+, Horizon dhe programe ndërkombëtare të ngjashme
Përmirësimi i Temave MSc	Jo	—	Po	Kërkohet përdorimi i literaturës nga revista të nivelit të lartë dhe metodologji e fortë kërkimore
Integrimi i Kërkimit shkencor në Mësimdhënie	Jo	—	Po	Kërkohet që përmbajtja e lëndeve të përditësohet rregullisht me gjetjet e fundit kërkimore

Tabela 11. Krahasoni i Rekomandimeve të Ekspertëve për Vitet (2022 dhe 2025)

Nga analiza e dy cikleve të vlerësimit për programin MSc në IAL – Pr2 (2022 dhe 2025), vërehet një kalim nga rekomandime themelore të fokusuar në përmbushjen e standardeve minimale të kërkimit, drejt rekomandimeve më të strukturuar, konkrete dhe të orientuara drejt cilësisë në vitin 2025. Vlerësimi i vitit 2022 ka nxjerrë në pah boshllëqe në planifikim, mungesë konsistence në publikime dhe angazhim të pamjaftueshëm të stafit në mobilitet akademik e ndërkombëtar. Ndërkohë, në vitin 2025 është vërejtur progres i dukshëm në përputhjen e programit me objektivat kërkimorë të institucionit, me theks në integrimin e kërkimeve në mësimdhënie, përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunimin me industrinë. Megjithatë, rekomandimet e panelit të ekspertëve në 2025 tregojnë se edhe pse struktura e përgjithshme e programit është përmirësuar, nevojiten hapa të mëtejshëm për të institucionalizuar kulturën kërkimore, për të përmirësuar cilësinë e publikimeve dhe për të forcuar lidhjen ndërmjet stafit dhe kërkimeve globale. Kjo tregon një rritje të pritshmërive dhe një thellim të vlerësimit në ciklin e dytë, i cili fokusohet jo vetëm në përputhshmëri, por edhe në performancë dhe ndikim të qëndrueshëm.

Analizë Krahase e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit, Akreditimi Institucional – IAL-Pr2

Kjo analizë krahason vlerësimet e standardit të kërkimit për programet Bachelor dhe Master në IAL–Pr2 me ato të kryera në nivel institucional në vitet 2019 dhe 2022, si dhe në vitet 2022 dhe 2025. Qëllimi është të vlerësohet qëndrueshmëria, progresi apo stagnimi në përmbushjen e standardeve të kërkimit si në nivelin programor ashtu edhe në atë institucional, si dhe të identifikohen fushat që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Fusha e Rekomandimit	Programet BSc & MSc	Akreditimi Institucional 2019	Akreditimi Institucional 2022
Strategjia e Kërkimit shkencor	E strukturuar sipas fushës	Objektiva të gjera, por mungojnë	E fokusuar në tre sektorë prioritarë, por e

	dhe ciklit të studimeve.	tregues të matshëm të progresit.	kufizuar për vitin 2021.
Përfshirja e Stafit	Stafi i përfshirë individualisht me obligime të qarta për publikime.	Stafi pritët të publikojë çdo vit (2 publikime në vit).	Prodhimtaria kërkimore lidhet me avancimin akademik dhe vlerësimin mbi bazë performance.
Publikimet	Publikime në revista të indeksuara, konferenca, libra profesionalë.	Përmend revista institucionale dhe konferenca vjetore.	Përmend sërish revista dhe Qendrën e Njohurive si kanalet kryesore të publikimit.
Etika në Kërkim	Procedura pjesërisht të përcaktuara; mungesë strukturash të qarta.	Kodi i Etikës nuk e mbulon plotësisht kërkimin shkencor; mungojnë struktura monitoruese.	Nuk ka politika të qarta për pronësinë intelektuale apo komercializimin e kërkimit shkencor.
Financimi i Kërkimit shkencor	Financim i kufizuar, shpesh i siguar nga burime të jashtme ose vetëfinancim.	Konsiderohet i mjaftueshëm në kontekstin institucional.	Vetëm 4% e buxhetit total të institucionit ishte ndarë në vitin 2021; ishte planifikuar rritje për vitin 2022.
Vlerësimi i Performancës	I lidhur me numrin e publikimeve dhe avancimin akademik.	Nuk përfshihej në vlerësimet individuale në atë kohë.	Një sistem i ri është në zhvillim, i harmonizuar me gradat akademike.

Tabela 12. Krahësimi i Vlerësimeve të Standardeve të Kërkimit shkencor

Nga analiza rezulton se ndërmjet viteve 2019 dhe 2022 ka pasur përpjekje për përmirësimin e standardit të Kërkimit shkencor, sidomos në nivel institucional me formalizimin e disa politikave të brendshme dhe krijimin e strukturave për menaxhimin e kërkimit shkencor. Megjithatë, shumë nga sfidat e identifikuara në vitin 2019 kanë vazhduar edhe në 2022, sidomos ato që lidhen me etikën në kërkim shkencor dhe komercializimin e rezultateve të kërkimit shkencor. Vlen të përmendet se vlerësimet për programet BSc dhe MSc ofrojnë njohuri më të detajuara mbi fusha specifike, ndërsa akreditimi institucional paraqet një analizë më të gjerë, duke reflektuar trende të zhvillimit strategjik në nivel institucional.

Gjatë shqyrtimit të vitit 2019, paneli i ekspertëve theksoi nevojën për zhvillimin e një sistemi individual të vlerësimit të performancës që përfshinë aktivitetet kërkimore. Ekspertët gjithashtu rekomanduan hartimin dhe miratimin e rregulloreve të qarta mbi parimet etike në kërkim shkencor, si dhe themelimin e një strukture të dedikuar për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Në shqyrtimin e vitit 2022, edhe pse u vlerësua përparimi në aspektin e publikimeve dhe motivimit për kërkime përmes shpërblimeve akademike, institucionit i mungonin ende politikat formale për pronësinë intelektuale dhe procedurat për komercializimin e rezultateve të kërkimit. Prandaj, rekomandimet u përqendruan në:

1. Krijimin e politikave për pronësinë intelektuale dhe procedura për komercializim të ideve dhe
2. Forcimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor përmes masave financiare dhe pritjeve më të qarta për stafin, duke përfshirë edhe gjatë rekrutimit dhe vlerësimeve vjetore të performancës.

Krahasimi mes dy rezultateve të vlerësimit tregon përparim në strukturimin dhe menaxhimin e aktiviteteve kërkimore, duke theksuar gjithashtu nevojën për vazhdimësi dhe konsolidim të kornizave rregullatore dhe etike.

Cikli / Programi	Niveli i Përputhshmërisë	Vëzhgime Kryesore
Akreditimi Institucional 2019	Përputhje Substanciale	Mungesë e politikave të qarta për etikën në kërkime shkencore dhe mungesë e sistemit për vlerësim të performancës.
Akreditimi Institucional 2022	Përputhje Substanciale	Përmirësim në motivimin për publikime; megjithatë, politika për të drejtat e pronës intelektuale dhe komercializimin mungojnë ende.
Programi BSc	Pjesërisht në përputhshmëri	Në shumicën e rasteve mungojnë publikimet e indeksuara nga stafi me kohë të plotë; standardi minimal është përmbushur pjesërisht.
Programi MSc	Përputhje Substanciale	Përputhshmëri më e lartë në krahasim me BSc; publikimet e stafit konsiderohen të pranueshme, megjithëse jo gjithmonë të

		dokumentuara sistematikisht.
--	--	---------------------------------

Tabela 13. Krahasimi i Vlerësimeve të Standardeve të Kërkimit shkencor

IAL-Pr2 ka treguar një qëndrueshmëri në përputhshmëri substanciale me standardin e kërkimit në të dy ciklet. Edhe pse ka përmirësim në aspektin e strukturave mbështetëse (si qendra kërkimore dhe politika për tituj akademik), ende mungojnë politikat e avancuara për etikë, pronësi intelektuale dhe integrim sistematik të kërkimit në performancë.

Në nivel programi, programi MSc tregon nivele më të larta përputhshmërie sesa programi BSc, pasi zakonisht vendos kërkesa më rigorozë dhe ka staf më të angazhuar në kërkimin shkencor. Megjithatë, ende mungon dëshmi e qartë dhe mbështetje formale institucionale për të siguruar që stafi të mund të përmbushë në mënyrë të qëndrueshme kriteret që lidhen me kërkimin shkencor.

Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL Pu3, BA

Ky seksion paraqet një analizë krahasuese të përputhshmërisë me standardin e kërkimit për programin BA të IAL-P3, duke krahasuar dy cikle të akreditimit: atë të vitit 2021 dhe atë të vitit 2024. Vlerësimi fokusohet në nën-standardet që lidhen me aktivitetet kërkimore, politikat institucionale, angazhimin e stafit dhe studentëve, si dhe mbështetjen për kërkime. Për secilin nën-standard jepen niveli i përputhshmërisë dhe rekomandimet për përmirësim, duke reflektuar ndryshimet dhe trendët mes dy cikleve.

Standardi	Vlerësimi 2021	Vlerësimi 2024	Dallimi	Komente / Rekomandime
6.1	Po	Jo	Regres	Rënie në burimet dhe qartësinë e objektivave kërkimore.
6.2	Po	Jo	Regres	Mungesë e qartë e pritshmërive për stafin dhe ndërveprimit kërkim-mësimdhënie.
6.3	Po	Po	Pa ndryshim	Përkufizimi formal i kërimit ekziston por realizimi është i pjesshëm.
6.4	Po	Po	Pa ndryshim	Performanca kërkimore e disa antarëve të stafit është nën nivelin e duhur.
6.5	Po	Jo	Regres	Publikime të kufizuara dhe pjesëmarrje e ulët në aktivitete.
6.6	Po	Po	Pa ndryshim	Standardi formal përmbushet, por duhet më shumë përfshirje metodologjike.
6.7	Po	Po	Pa ndryshim	Përmbushje minimale e kërkesave – disa prej antarëve të

				stafit nën performancë.
6.8	Po	Po	Pa ndryshim	Publikime të realizuara në emrin institucional.
6.9	Po	Jo	Regres	Ndërlidhja e kërkim-mësimdhënie e kufizuar në praktikë.
6.10	Po	Po	Pa ndryshim	Pronësia intelektuale është e garantuar nga vetëdija institucionale.
6.11	Po	Po	Pa ndryshim	Pjesëmarrja e studentëve në kërkim është modeste, por e pranishme.

Tabela 14. Vlerësimi Krahases i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit

Në krahasimin ndërmjet cikleve të riakreditimit të viteve 2021 dhe 2024 për programin BA, vihet re një regres i dukshëm në përputhshmërinë me standardet e kërkimit. Në vitin 2021, programi ka treguar një angazhim të lartë të stafit akademik në aktivitete kërkimore, me plane konkrete dhe bashkëpunime ndërkombëtare aktive, duke arritur përputhshmëri të konsiderueshme me shumicën e standardeve. Ndërkohë, në vlerësimin e vitit 2024, përkundër përpjekjeve të vazhduara, evidentohet mungesë e fokusit të qartë në objektivat kërkimore, resurse të pamjaftueshme dhe pjesëmarrje të kufizuar të stafit në kërkime, çka reflekton një

përputhshmëri më të ulët. Kjo tregon nevojën për rikthim në qasje më strategjike dhe investime më të qëndrueshme në kërkimin shkencor.

Rekomandimet 2021	Rekomandimet 2024
1. Universiteti të krijojë një njësi për zhvillimin e kërkimit shkencor (në nivel universitar).	1. Të intensifikohen përpjekjet kërkimore.
2. Strategjia e Departamentit duhet të sigurojë përfshirjen e studentëve në kërkim.	2. Të rritet numri i publikimeve kërkimore.
	3. Të integrohen rezultatet aktuale të kërkimit shkencor në procesin e mësimdhënies.

Tabela 15. Përmbledhje e Komenteve dhe Rekomandimeve të Panelit të Ekspertëve mbi Standardin e Kërkimit (2021 dhe 2024)

Në vitin 2021, rekomandimet ishin të fokusuara në krijimin e strukturave institucionale për mbështetjen e kërkimit dhe përfshirjen e studentëve në aktivitete kërkimore, çka tregon një mjedis pozitiv me potencial të lartë zhvillimi. Në vitin 2024, rekomandimet theksojnë mangësi substanciale në zbatimin e politikave të kërkimit, nevojën për publikime më të shumta dhe për integrim të kërkimit në mësimdhënie. Kjo tregon një rënie të performancës kërkimore, si dhe nevojën për përforcimin e angazhimit të stafit akademik në aktivitete të strukturuar kërkimore.

Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit — IAL Pu3 MSc

Ky seksion përmban një analizë krahasuese të vlerësimit nga ekspertët e fushës gjatë akreditimit të programit MSc në IAL Pu3, ndërmjet cikleve të akreditimit 2021 dhe 2024. Analiza fokusohet në Standardin 6 (Kërkimi) dhe përfshin dallimet në vlerësim, përputhshmëri me standardet, si dhe komentet dhe rekomandimet nga panelet e ekspertëve për secilin nënstandard.

Standar di 6 Tregues it	Vlerësi mi 2021	Vlerësi mi 2024	Dallimi në përputhshm ëri	Dallimet në komente/rekomandi me
6.1	C	B	Përmirësim	Përcaktimi i objektivave të qarta kërkimore në planin strategjik. Rritje e mbështetjes logjistike dhe dokumentacionit.
6.2	B	B	Pa ndryshim	Përfshirje e qartë në vlerësimin e stafit, por mbështetja praktike për bashkëpunim me industrinë mbetet sfidë.
6.3	B	B	Pa ndryshim	Treguesit për kërkim shkencor janë të definuar, por mungon përkufizimi direkt i kërkimit shkencor.
6.4	B	B	Pa ndryshim	Përputhje e temave të kërkimit shkencor me programin. Disa devijime të vogla.
6.5	B	A	Përmirësim	Përfshirje më e madhe ndërkombëtare. I gjithë stafi ka publikime dhe profile në Google Scholar.

6.6	B	B	Pa ndryshim	Validim përmes konferencave dhe publikimeve. Strukturat tjera mungojnë.
6.7	B	B	Pa ndryshim	Mesatarisht një publikim në vit për çdo anëtar të stafit. Nuk ka rënie.
6.8	A	A	Pa ndryshim	Publikime në emër të UPZ-së.
6.9	C	C	Pa ndryshim	Mungesë e strukturave për komercializim të kërkimit shkencor.
6.10	C	B	Përmirësim	Përfshirje më e madhe e studentëve në projektet kërkimore dhe objektivat strategjik.

Tabela 16. Vlerësimi Krahësues i Përputhshmërisë së Fushës së Standardit të Kërkimit

Gjatë vlerësimit të vitit 2021, programi MSc kishte disa boshllëqe në dokumentimin dhe strukturimin e objektivave kërkimore dhe mekanizmave për komercializimin e tyre. Në vitin 2024, është evidentuar përmirësim në disa nënstandarde si 6.1 dhe 6.5, duke reflektuar qartësi më të madhe strategjike, pjesëmarrje më të lartë ndërkombëtare dhe përfshirje më të mirë të studentëve. Megjithatë, aspekti i bashkëpunimit me industrinë dhe strukturat për komercializimin e rezultateve të kërkimit shkencor mbetet sfidë dhe kërkon më shumë përpjekje institucionale.

Fusha e rekomandimit	Rekomandime 2021	Rekomandime 2024
Objektivat kërkimore	Përcaktim i qartë i objektivave të programit MSc	Përcaktimi i prioriteteve kërkimore në dy fusha kryesore
Bashkëpunimi me industrinë	Krijimi i një strukture për bashkëpunim me kompanitë	Zhvillim i strategjisë së bashkëpunimit me sektorin industrial
Komercializimi i kërkimeve	Themelimi i qendrës për komercializim të kërkimit shkencor	Procedura për pronësi intelektuale ende mungon
Përfshirja e studentëve	Rritje e përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore	Planifikohet përfshirja në projekte me industri

Tabela 17. Krahassimi i Rekomandimeve të Ekspertëve

Rekomandimet e dhëna në ciklin 2021 kanë theksuar mungesën e strukturës për zhvillim kërkimor dhe përkrahje për komercializim. Në vitin 2024, përmirësimet janë të dukshme në definimin e fushave prioritare dhe përfshirjen e studentëve, por mbetet e pazhvilluar qartësia mbi komercializimin dhe bashkëpunimin formal me industrinë. Institucioni ka bërë hapa drejt institucionalizimit të kërkimit, por është ende në fazë të tranzicionit drejt përmbushjes së plotë të standardeve.

Analizë Krahase e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit, Akreditimi Institucional – IAL-Pu3

Ky seksion paraqet një analizë krahasuese të vlerësimit të standardit të kërkimit ndërmjet akreditimit institucional (2020 dhe 2023) dhe akreditimit të dy programeve studimore (BA dhe MSc) për institucionin IAL-Pu3. Analiza fokusohet në nivelin e përputhshmërisë me standardin

e Kërkimit, komentet dhe rekomandimet e dhëna nga ekspertët, si dhe trendët në zhvillimet kërkimore me kalimin e kohës për këtë institucion.

Fusha e Vlerësimit	BA (2021 dhe 2024)	MSc (2021 dhe 2024)	Institucional (2020 dhe 2023)
Fokusimi në Kërkim Shkencor	Rënie në objektiva dhe mbështetje institucionale; regres në disa nëntstandarde.	Përmirësim në qartësinë strategjike dhe angazhimin ndërkombëtar.	Fillimisht vizion ambicioz; më pas mungesë mbështetje financiare dhe ulje e përputhshmërisë.
Vlerësimi i Përgjithshëm	Pjesërisht në përputhshmëri me regres të dukshëm në 2024.	Nga “pjesërisht” në “substancialisht në përputhshmëri” me përmirësime të dukshme.	Fillimisht “në përputhje të plotë” (2020), më pas “pjesërisht në përputhshmëri” (2023).
Strukturat mbështetëse	Mungesë njësie kërkimore dhe përkrahje strukturore.	Evidentim i mekanizmave të mbështetjes dhe planeve për bashkëpunim me industrinë.	Zhvillim i dokumenteve dhe strukturave, por mungesë zbatim praktik.
Publikimet si Dëshmi e Performancës së Kërkimit shkencor	Rënie në cilësinë dhe sasinë e publikimeve në 2024.	Rritje e përfshirjes dhe klasifikimi i publikimeve sipas faktorëve të impaktit.	Publikime në rritje, por mungesë e treguesve dhe transparencës së buxhetit.
Pjesëmarrja e stafit dhe studentëve	Përfshirje e kufizuar e studentëve	Përmirësim në përfshirje të studentëve në	Theksohet si rekomandim për përfshirje më të

	dhe stafi nën pritshmëri.	projekte kërkimore.	madhe të studentëve.
--	---------------------------	---------------------	----------------------

Tabela 18. Përmbledhje e Komenteve dhe Rekomandimeve të Panelit të Ekspertëve mbi Standardin e Kërkimit shkencor

Analiza e mësipërme tregon se programi MSc ka bërë përparime të rëndësishme në përmbushjen e standardit të kërkimit, duke kaluar në nivelin “Përputhshmëri Substanciale”, ndërsa programi BA shfaq regres të dukshëm në përputhshmëri. Vlerësimi institucional paraqet sfida sistemike, me një rënie nga përputhshmëria e plotë në pjesërisht në përputhshmëri për shkak të mungesës së mbështetjes buxhetore dhe strukturave mbështetëse.

Niveli i Vlerësimit	Viti 2021	Viti 2024	Vlerësimi i Përgjithshëm
Programi BA	Pjesërisht në përputhshmëri	Pjesërisht me regres	Pjesërisht në përputhshmëri
Programi MSc	Pjesërisht në përputhshmëri	Përputhshmëri substanciale	Përputhshmëri substanciale
Institucional	Në përputhje të plotë	Pjesërisht në përputhshmëri	Pjesërisht në përputhshmëri

Tabela 19. Krahësimi i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit shkencor

Bazuar në vlerësimet për programet dhe institucionin, mund të konkludohet se ka progres në programin MSc, regres në programin BA, dhe qëndrueshmëri sfiduese në nivelin institucional. Institucioni duhet të fokusohet në koordinimin më të mirë të politikave, buxhetit dhe përfshirjes në kërkim për të arritur përputhshmëri të plotë me standardin e kërkimit shkencor.

Vlerësimi i Fushës së Standardit të Kërkimit – IAL-Pr4, BSc

Ky seksion përmban një analizë krahasuese të vlerësimit nga ekspertët e fushës gjatë akreditimit të programit BSc në IAL-P4, ndërmjet cikleve të akreditimit 2019 dhe 2024. Analiza fokusohet në Standardin 6 (Kërkimi) dhe përfshin dallimet në vlerësim, përputhshmëri me standardet, si dhe komentet dhe rekomandimet nga panelet e ekspertëve për secilin nënstandard.

Standardi 6 Treguesit	Vlerësimi 2019	Vlerësimi 2024	Dallimet dhe Komentet
6.1	C	B	Në 2024, ka objektiva të qarta, financim dhe përfshirje të Infermierisë në planin e kërkimit shkencor.
6.2	B	B	Pjesëmarrja e stafit në kërkim shkencor, përfshirë avancimin dhe vlerësimin e performancës.
6.3	C	A	Politika të përditësuara për përcaktimin e kërkimit shkencor në përputhje me standardet ndërkombëtare.
6.4	B	B	Dëshmi të përshtatjes midis temave të kërkimit shkencor dhe fushës së mësimdhënies.
6.5	C	A	Publikime në revista relevante, pjesëmarrje në ngjarje shkencore.

6.6	C	B	Validim përmes publikimeve në WoS/Scopus dhe politika për pronësinë intelektuale.
6.7	C	A	Publikimi i një artikulli në vit për stafin, një standard i ri nga viti 2019.
6.8	B	A	Publikime të detyrueshme nën emrin e institucionit.
6.9	C	C	Integrimi i kërkimit shkencor në mësimdhënie dhe përditësimi i përmbajtjes së lëndëve.
6.10	C	A	Angazhim i studentëve përmes projekteve dhe seminareve të udhëhequra

Tabela 20. Vlerësimi Krahësues i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit

Fusha e Rekomandimit	Rekomandimet 2019	Rekomandimet 2024
Kriteret dhe treguesit e kërkimit shkencor	Përfshirja e treguesve të kërkimit shkencor në kriteret e promovimit	Zhvillim intensiv dhe fuqizim i aktivitetit kërkimor
Publikimet	Botimi i monografive kolektive në gjuhën shqipe	Inkurajimi i publikimeve të përbashkëta me akademikë europianë
Strategjia	—	Zhvillimi i një strategjie specifike për programin

Trajnimi i stafit	—	Trajnim metodologjik i vazhdueshëm për stafin e programit
Fokusimi i kërkimit shkencor	—	Fokusimi i kërkimit shkencor brenda programit si fushë shkencore
Përfshirja e palëve të interesit	—	Përfshirja e mentorëve klinikë dhe studentëve në kërkimin shkencor aplikativ
Kërkim ndërdisiplinor / i përbashkët	—	Zhvillimi i kërkimit të përbashkët në të gjitha programet e shëndetësisë
Mobiliteti	—	Rritje e mobilitetit të stafit akademik (hyrës dhe dalës)

Tabela 21. Përmbledhje e Komenteve dhe Rekomandimeve të Panelit të Ekspertëve mbi Standardin e Kërkimit shkencor

Në vitin 2019, vlerësimi i programit BSc u fokusua në themelimin e bazës për kërkim shkencor. Megjithatë, nuk u bë një vlerësim i veçantë për secilin nëntstandard, pasi paneli i ekspertëve nuk e përfshiu në raportin e tyre shkallën e përputhshmërisë për nëntstandartet individuale. Përshkrimi thekson sfidat që lidhen me mungesën e burimeve financiare dhe kohën e kufizuar të stafit për angazhim në kërkim shkencor. Pavarësisht këtyre sfidave, institucioni ka treguar përkushtim për përmirësim të vazhdueshëm përmes mbështetjes për doktoratura, konferenca dhe projekte kolektive. Rekomandimet janë orientuar drejt formalizimit të kërkesave për kërkim shkencor në kritere promovimi dhe publikimeve në gjuhën shqipe.

Në vitin 2024, vlerësimi ka qenë dukshëm më i strukturuar dhe i bazuar në tregues të matshëm. Institucioni ka zhvilluar një kornizë

metodologjike për vlerësimin e kapaciteteve kërkimore, duke përfshirë elemente si infrastruktura, bashkëpunimet, fuqizimi i stafit dhe shpërndarja e rezultateve. Përmirësimet janë të dukshme në përkrahjen financiare, politikën e qartë për publikime dhe përfshirjen e studentëve. Megjithatë, sfidat kryesore mbeten në fuqizimin e kërkimeve shkencore të lidhura direkt me infermierinë, rritjen e bashkëpunimeve dhe publikimeve të përbashkëta me akademikë ndërkombëtarë.

Analizë Krahase e Vlerësimit të Fushës së Standardit të Kërkimit IAL Pr4– MSc

Ky seksion përmban një analizë krahasuese të vlerësimit nga ekspertët e fushës gjatë akreditimit të programit MSc në IAL P4, ndërmjet cikleve të akreditimit 2019 dhe 2022. Analiza fokusohet në Standardin 6 (Kërkimi) dhe përfshin dallimet në vlerësim, përputhshmëri me nënstandartet, si dhe komentet dhe rekomandimet nga panelet e ekspertëve për secilin nënstandard.

Standard i 6 Treguesit	Vlerësimi 2019	Vlerësimi 2022	Dallimi në përputhshmëri	Komentet / Dallimet kryesore
6.1	Po	Po	Pa ndryshim	Financim i strukturuar për kërkim; përmirësim i infrastrukturës
6.2	Jo	Po	Përmirësim	Përcaktim më i qartë i përfshirjes së stafit në kërkim

6.3	Po (pjesërisht)	Po	Përmirësim	Politika më të qarta dhe përputhje më e lartë me standardet ndërkombëtare
6.4	Po (pjesërisht)	Po	Përmirësim	Korelacion më i mirë ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit
6.5	Jo	Po	Përmirësim	Pjesëmarrje më e gjerë në publikime dhe konferenca
6.6	Jo	Po	Përmirësim	Evidencë më e qartë për validim të kërkimit
6.7	Po	Jo	Rënie	Performancë më e dobët në publikime të rregullta nga stafi
6.8	Jo	Po	Përmirësim	Të gjitha publikimet nën emrin e institucionit

6.9	Po	Po	Pa ndryshim	Përfshirje aktive e rezultateve të kërkimit në mësimdhënie
6.10	Po	Po	Pa ndryshim	Zhvillim i politikave për të drejtat e pronësisë intelektuale
6.11	Po	Po	Pa ndryshim	Pjesëmarrje aktive e studentëve në projekte kërkimore

Tabela 22. Vlerësimi Krahases i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit

Nga krahasimi i vlerësimeve të vitit 2019 dhe 2022, është evident një përmirësim i përgjithshëm në shumicën e nëntstandardeve të kërkimit shkencor për këtë program. Megjithatë, disa nëntstandarde (6.1, 6.9, 6.10 dhe 6.11) nuk tregojnë ndryshim në nivelin e përputhshmërisë, ndërsa nëntstandardi 6.7 tregon madje një regres. Kjo sugjeron se, megjithëse janë bërë përparime në forcimin e kapaciteteve kërkimore, ende ka fusha që kërkojnë vëmendje dhe zhvillim të vazhdueshëm. Përmirësime të dukshme janë identifikuar në përfshirjen e stafit në aktivitete kërkimore, politika më të qarta lidhur me atë që konsiderohet kërkim shkencor, përputhje më të lartë të kërkimit shkencor me fushën e studimit, si dhe rritje të pjesëmarrjes së studentëve në projektet kërkimore. Megjithatë, Standardi 6.7 mbetet problematik në vitin 2022 për shkak se një pjesë e konsiderueshme e stafit nuk ka arritur të përmbushë kriterin e publikimit të një artikulli në vit. Kjo tregon nevojën për forcimin e kapaciteteve dhe strategjive për të mbështetur kërkimin shkencor akademik.

Fusha e Rekomandimit	Rekomandimet 2019	Rekomandimet 2022
Kritere për Publikime	Riformulim i kriterëve për publikime; fokus në cilësi më shumë sesa në sasi	Zhvillimi i një strategjie për rritjen e numrit të publikimeve të stafit
Partneritete dhe Bashkëpunime	—	Përmirësimi i partneriteteve dhe qartësimi i përgjegjësi të stafit

Tabela 23. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të panelit të ekspertëve mbi standardin e Kërkimit shkencor

Rekomandimet e vitit 2019 ishin të fokusuara në ndalimin e praktikave të publikimeve me vlerë të ulët dhe theksimin e kërkimeve cilësore në platforma të njohura ndërkombëtare. Në vitin 2022, fokusi është zhvendosur drejt përmirësimit të strukturës së kërkimit, përfshirjes më të gjerë të stafit dhe krijimit të një strategjie të qartë për rritjen e rezultateve të kërkimit. Kjo tregon për një vetëdijesim më të madh institucional për rëndësinë e kërkimit cilësor dhe për nevojën për strategji të qëndrueshme afatgjate.

Analizë Krahase e Fushës së Standardit të Kërkimit – Akreditim Institucional IAL Pr4

Në këtë pjesë paraqitet analiza dhe krahasimi i standardit të kërkimit për institucionin IAL P4 në nivel institucional, për ciklet e vlerësimit të viteve 2022 dhe 2024.

Stand ardi 6 Tregu esit	Vlerë simi (BSc 2019 dhe 2024)	Vlerë simi (MSc 2019 dhe 2022)	Instituc ional 2022	Instituc ional 2024	Dallimi në përpuths hmëri	Komente / Dallimet Kryesore
6.1	Po	Po	Po	Po	Përmirës im	Integrim më i qartë institucio nal; mekaniz ma më të mirë planifiki mi dhe buxhetimi .
6.2	Po –	Jo	Po	Po	Përmirës im	MSc tregoi mangësi në përfshirje n e stafit; niveli institucio nal forcoi bashkëpu nimet rajonale.
6.3	Po –	Pjesër isht	Jo	Po	Përmirës im	Dobësi në MSc dhe fazën

						institucionale të 2022, por përmirësim në koherencë dhe lidhje tematike deri në 2024.
6.4	Jo	Po	Jo	Po	Përmirësim	Mbështetja institucionale u bë më sistematike në 2024 pas mungesave të burimeve më parë.
6.5	Po	Po	Jo	Po	Përmirësim	Cilësia dhe kategorizimi i publikimeve u përmirësuan në nivel institucio

						nal (2024).
6.6	Jo	Jo	Jo	Po	Përmirësim	Mangësi të vazhdueshme në nivel programi, përmirësimi i zbatimit institucional deri në 2024.
6.7	Po	Po	Jo	Po	Përmirësim	Integrimi plotë institucional deri në 2024 pas aplikimit të paqëndrueshëm.
6.8	Po	Po	Jo	Po	Përmirësim	Niveli institucional riafirmoi përfshirjen përmes trajnimeve dhe praktikave të qarta.

6.9	Jo	Jo	Jo	Po	Përmirësim	Politika institucionale lidhi publikimi nën emrin institucionale me mbështetje financiare .
6.10	Po	Po	Jo	Po	Përmirësim	Kuadri institucionale u qartësua dhe formalizua (2021–2024).
6.11	Po –	Po	Po	Po	Përmirësim	Përputhshmëri e qëndrueshme gjatë cikleve; procedurat institucionale u forcuan, por pa ndryshim të madh.

Tabela 24. Vlerësimi Krahases i Përputhshmërisë me Fushën e Standardit të Kërkimit

Në vitin 2022, performanca kërkimore në nivel institucional u vlerësua si pjesërisht e përmbushur me një nivel përputhshmërie prej 55%. Strategjia kërkimore ishte e kufizuar në kohëzgjatje dhe mungonte mbështetja e mjaftueshme financiare. Në programin MSc, megjithëse kishte përpjekje për zhvillim të politikave kërkimore, vërehej mungesë e dukshme e përmbushjes së standardeve për publikime vjetore dhe përfshirje ndërkombëtare. Programi BSc në të njëjtin vit tregonte po ashtu sfida të ngjashme me një nivel të ulët të publikimeve të indeksuara dhe mungesë të qartësisë në objektivat kërkimore.

Në vitin 2024, IAL Pr4 tregoi përmirësime në zhvillimin e strategjisë së kërkimit shkencor, me dokumente të miratuara për menaxhimin dhe financimin e kërkimeve shkencore. Krijimi i Instituteve për Kërkime Shkencore dhe njësisë u vlerësua si praktikë e mirë, por mungonte përfshirja aktive e studentëve dhe mentorimi për hulumtuesit e rinj. Ndërkohë, bashkëpunimi ndërkombëtar ishte më i theksuar në krahasim me vitin 2022 përmes rrjeteve dhe partneriteteve rajonale. Kjo sinjalizon një rritje të kapacitetit kërkimor institucional.

Viti / Niveli	Rekomandimi 1	Rekomandimi 2	Rekomandimi 3
BSc (2019)	Përfshirja e treguesve të kërkimit shkencor në kriteret e promovimit	Botimi i monografive kolektive në gjuhën shqipe	—
BSc (2024)	Zhvillim intensiv dhe fuqizim i	Inkurajimi i publikimeve të përbashkëta	Zhvillimi i një strategjie specifike për programin; Trajnim

	aktivitetit kërkimor	me akademikë evropianë	metodologjik i vazhdueshëm për stafin; Fokusimi i kërkimit shkencor brenda programit; Përfshirja e mentorëve klinikë dhe studentëve në kërkimin shkencor aplikativ; Zhvillimi i kërkimit shkencor të përbashkët në të gjitha programet e shëndetësisë; Rritja e mobilitetit të stafit akademik
MSc (2019)	Tema të reja kërkimore të lehta për zbatim: përdorimi i barnave, sjellja racionale	Publikimet duhet të jenë të indeksuara në PubMed/Web of Science (WoS)	—
MSc (2022)	Rritja e numrit të stafit me publikime që plotësojnë kriteret	Përgatitja e CV-ve vetëm për stafin e MSc, me detaje për mësimdhënien dhe publikimet	Zhvillimi i një strategjie për rritjen e publikimeve

Institucional (2022)	Ofrimi i më shumë nxitjeve për aktivitetet kërkimore	Rishikimi i ndarjes së buxheteve për kërkim shkencor	Zhvillimi i një plani strategjik afatgjatë për kërkimin shkencor
Institucional (2024)	Përfshirja e studentëve në aktivitetet kërkimore	Mbështetja e hulumtuesve të rinj	Zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore

Tabela 25. Përmbledhje e Komenteve dhe Rekomandimeve të Panelit të Ekspertëve mbi Standardin e Kërkimit

Rekomandimet e dhëna në vlerësimet për BSc, MSc dhe vlerësimet institucionale po tregojnë një evolucion të vazhdueshëm në qasjen ndaj kërkimit shkencor. Në anën tjetër, rekomandimet institucionale kanë adresuar më shumë çështje strukturore dhe strategjike, përfshirë ndarjen e buxhetit, krijimin e planeve afatgjata dhe stimuj për përfshirjen e studentëve dhe hulumtuesve të rinj. Një trend pozitiv është angazhimi në revista ndërkombëtare dhe krijimi i një infrastrukture rregullative për menaxhimin e kërkimit shkencor.

Program/ Accreditation	Year	Level of Compliance
Program BSc	2019	Përputhshmëri Substanciale
Program BSc	2024	Përputhshmëri Substanciale
Program MSc	2019	Përputhshmëri Substanciale
Program MSc	2022	Përputhshmëri Substanciale

Akreditimi Institucional	2022	Pjesërisht në Përputhshmëri
Akreditimi Institucional	2024	Përputhshmëri Substanciale

Tabela 26. Krahasoni i Niveleve të Përputhshmërisë me Standardin e Kërkimit shkencor

Të gjitha vlerësimet për programet, si në vitin 2019 ashtu edhe në ciklet e mëvonshme (2022 dhe 2024), janë vlerësuar si “Përputhshmëri Substanciale”, që tregon një nivel të kënaqshëm të zbatimit të kërkimit shkencor në praktikën akademike të drejtpërdrejtë. Ndërkohë, akreditimi institucional i vitit 2022 është vlerësuar si “Pjesërisht në Përputhshmëri”, duke reflektuar sfida të mëdha në aspektin e strukturave mbështetëse, planifikimit strategjik dhe burimeve institucionale për kërkim shkencor. Edhe pse në vitin 2024 është arritur një përmirësim me një vlerësim “Përputhshmëri Substanciale”, ende mbetet e qartë se vlerësimi në nivel programi ka qenë më konsistent dhe më pozitiv në krahasim me vlerësimin në nivel institucional, duke sugjeruar se përpjekjet për kërkim shkencor janë më të përqendruara në nivel të njësive akademike sesa në politikat e përgjithshme institucionale dhe kornizat organizative për kërkimin shkencor dhe politikat përkatëse.

Seksioni III

Analiza e Publikimeve Shkencore në IAL

Kjo pjesë e analizës fokusohet në vlerësimin e aktivitetit kërkimor në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Kosovë gjatë periudhës 2021–2024, me theks të veçantë në publikimet shkencore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e brendshëm institucional, si dhe në përmbushjen e kërkesave të jashtme që burojnë nga standardet e sigurimit të cilësisë. Aktiviteti kërkimor përbën një komponent themelor për legjitimitetin akademik dhe zhvillimin strategjik të IAL-ve, duke ndikuar drejtpërdrejt në rangimin e tyre, reputacionin ndërkombëtar dhe aftësinë për të tërhequr bashkëpunime dhe fonde të jashtme.

Analiza përfshin të dhëna të mbledhura përmes një pyetësori të strukturuar, i cili është shpërndarë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend. Në këtë proces janë përfshirë përgjigjet nga 16 institucione përfaqësuese, si publike ashtu edhe private. Qëllimi i pyetësorit ka qenë gjenerimi i të dhënave të matshme mbi performancën kërkimore të IAL-ve. Kjo analizë synon jo vetëm të adresojë prodhimin akademik në mënyrë sasiore, por edhe të shqyrtojë se si ky aktivitet përkthehet në progres të brendshëm institucional dhe ndikim në treguesit e jashtëm të cilësisë. Në këtë kontekst, aktiviteti kërkimor shihet si një faktor kyç i ndërlidhur me zhvillimin profesional të stafit akademik, përf forcimin e kapaciteteve institucionale dhe fuqizimin e pozicionimit të IAL-ve në rrjetet globale të arsimit dhe shkencës.

Gjithashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar kontekstit sfidues ku veprojnë këto institucione, përfshirë mungesën e infrastrukturës së avancuar kërkimore, kufizimet buxhetore dhe mungesën e politikave afatgjata për mbështetjen sistematike të kërkimit shkencor. Megjithatë, janë identifikuar edhe praktika të mira, veçanërisht në institucione ku janë ndërmarrë hapa konkretë për integrimin e kërkimit shkencor në misionin institucional dhe për nxitjen e stafit akademik për të marrë pjesë në projekte ndërkombëtare, publikime dhe rrjete profesionale.

Nëpërmjet kësaj analize, synohet të nxirren përfundime të argumentuara mbi progresin dhe barrierat ekzistuese në fushën e kërkimit shkencor,

duke ofruar rekomandime të dobishme për politikat institucionale, vendimmarrjen strategjike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.

Tabela përmbledhëse e kërkimit shkencor (2021–2024)

Kjo tabelë përmbledh të dhënat mbi kërkimin shkencor për vitet 2021–2024, duke përfshirë numrin e publikimeve në revista me faktor ndikimi, bashkëautorësinë ndërkombëtare dhe projektet e financuara. Këto të dhëna janë mbledhur përmes pyetësorëve të shpërndarë në IAL-të në Kosovë, siç u përmend më sipër.

Viti	Publikime në Revista me Faktor Impakti	Bashkautorë Ndërkombëtarë	Projekte me Financim (Grante)
2021-2022	165	99	99
2022-2023	170	111	108
2023-2024	264	117	134

Tabela 27. Publikime shkencore (2021–2024) Kërkime Shkencore të Publikuara

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë tregojnë qartë një trend në rritje të numrit të publikimeve shkencore në vitet e fundit. Sipas rezultateve, 76.5% e të anketuarve deklaruan se ka pasur rritje, ndërsa vetëm një pjesë e vogël (17.6%) e konsiderojnë atë të qëndrueshme ose në rënie. Ky perceptim i përgjithshëm i rritjes tregon për një përmirësim të kulturës kërkimore brenda institucioneve, si dhe një përgjigje pozitive ndaj kërkesave të reja për cilësi dhe performancë akademike.

Në qendër të kësaj rritjeje janë disa faktorë kyç që janë përmendur shpesh nga pjesëmarrësit. Kriteret nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) përmenden si një nga faktorët më ndikues, pasi standardet më të repta

për akreditim dhe avancim akademik kanë shtyrë institucionet dhe stafin të fokusohen më shumë në publikime cilësore dhe revista me faktor ndikimi. Në këtë kontekst, promovimi akademik dhe rregulloret e brendshme për avancimin janë theksuar si shtytës të rëndësishëm që krijojnë presion pozitiv dhe motivim për publikim shkencor, shpesh të lidhur drejtpërdrejt me përfitime karriere.

Një tjetër faktor i rëndësishëm është përfshirja në rritje në projekte ndërkombëtare, e cila jo vetëm që kontribuon në rritjen e numrit të publikimeve përmes bashkëpunimeve, por gjithashtu përmirëson ekspozimin dhe standardet profesionale të stafit akademik. Shumë institucione raportojnë se përmes angazhimit në këto projekte kanë fituar qasje në burime, rrjete kërkimore dhe revista të indeksuara si SCOPUS dhe Web of Science, të cilat janë tregues objektivë të cilësisë së kërkimit shkencor.

Nga ana tjetër, politikat e brendshme institucionale kanë qenë të rëndësishme në këtë proces. Disa universitete dhe kolegje kanë miratuar rregullore të veçanta për financimin e kërkimit shkencor dhe mbështetjen e publikimeve, përfshirë fonde për botime, bonuse për stafin dhe projekte të vogla që shërbejnë si nxitje për angazhimin kërkimor. Në disa raste janë përmendur platforma digjitale për regjistrimin dhe monitorimin e performancës kërkimore, duke rritur transparencën dhe duke bërë progresin më të matshëm.

Megjithatë, pavarësisht këtij përparimi, një numër i vogël institucionesh raportojnë një rënie ose stagnim të përkohshëm, duke identifikuar një sërë pengesash. Këto përfshijnë mungesën e infrastrukturës kërkimore, numër të pamjaftueshëm të stafit akademik të rregullt dhe mungesën e burimeve financiare të qëndrueshme për kërkimin shkencor. Disa përfaqësues kanë theksuar se edhe pse numri i përgjithshëm i publikimeve nuk ka pësuar ulje, ka pasur një zhvendosje drejt publikimit më serioz në revista me ndikim më të lartë, gjë që natyrisht mund të shoqërohet me një numër më të kufizuar publikimesh në periudha afatshkurtra.

Platformat për Botimin e Punimeve Shkencore

Të dhënat nga përgjigjet tregojnë një dominim të qartë të platformave të indeksuara ndërkombëtarisht në publikimet e fundit. Platforma më e përdorur është SCOPUS, një përqindje e madhe e të anketuarve që tregojnë përdorimin e saj, duke reflektuar orientimin e institucioneve drejt burimeve me faktor ndikimi të njohur ndërkombëtarisht. Pas saj renditet Web of Science një tjetër burim kredibil për publikime shkencore të nivelit të lartë.

Një përqindje e konsiderueshme raportuan publikime në Google Scholar, që shpesh përdoret për akses më të lehtë dhe për ekspozim më të gjerë akademik. ResearchGate dhe Academia.edu (janë gjithashtu të pranishme, megjithëse më shumë si platforma për shpërndarje sesa si burime kryesore për publikime me faktor ndikimi. Rreth një e katërta e të anketuarve përmendën platforma të tjera, të cilat mund të përfshijnë revista me indeksim të kufizuar ose në gjuhë lokale, që gjithsesi kontribuojnë në profilin kërkimor të stafit.

Fushat shkencore të publikimeve

Publikimet janë shpërndarë në një gamë të gjerë fushash akademike, çka reflekton strukturën shumë disiplinore të arsimit të lartë në Kosovë. Nga të dhënat, mund të identifikohen këto fusha kryesore të dominimit:

1. Shkenca Shoqërore dhe Ekonomia

Këto janë fushat më të përfaqësuara, duke përfshirë arsimin, juridikun, menaxhimin, psikologjinë, punën sociale dhe shkencat politike. Kjo korrespondon me ofertat më të gjera të programeve në shumë institucione.

2. Inxhinieri dhe Teknologji

Një numër i konsiderueshëm i publikimeve i përket fushave të inxhinierisë së kompjuterëve, mekanikës, teknologjisë ushqimore dhe arkitekturës. Kjo tregon një rritje të aktivitetit kërkimor edhe në fusha teknike që tradicionalisht kërkojnë më shumë mbështetje laboratorike dhe infrastrukture.

3. Shkencat Natyrore dhe Mjekësore

Disa institucione raportuan publikime në mjekësi, shkenca veterinare, shkencat e sportit dhe biologji. Kjo është domethënëse për universitetet publike ose institucionet me qendra kërkimore të organizuara mirë.

4. Arte dhe Shkenca të Aplikuara

Arkitektura, turizmi dhe arte të tjera të aplikuara janë përmendur veçanërisht nga institucionet që kanë programe të profilizuara. Ato kombinojnë kërkimin teorik me prodhimin praktik (p.sh. punë dizajni apo analiza kulturore).

1. Fusha Ndërdisciplinore dhe të Specializuara

Disa përgjigje kanë përfshirë fusha si albanologjia, shkencat fetare dhe filologjia, që ndonëse nuk janë ndër më të mëdhatë për nga volumi i publikimeve, përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore.

Analizë mbi Strategjitë, Rregulloret dhe Mekanizmat Mbështetës për Kërkimin Shkencor në IAL-të në Kosovë

Një numër i konsiderueshëm i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë kanë ndërmarrë hapa konkretë drejt zhvillimit dhe institucionalizimit të kërkimit shkencor si një komponent kyç të misionit të tyre akademik. Të dhënat nga anketa tregojnë se 77.8% e institucioneve kanë një strategji të brendshme për zhvillimin e kërkimit shkencor, që përfaqëson një përqindje relativisht të lartë dhe tregon një vetëdijesim të qëndrueshëm për rëndësinë e kërkimit shkencor në zhvillimin institucional dhe akademik. Megjithatë, një pjesë (22.2%) ende nuk kanë një strategji të qartë, duke shënuar një hendek në planifikimin afatgjatë të kërkimit shkencor.

Në mënyrë pozitive, 100% e institucioneve raportojnë se kanë dokumente ose rregullore të brendshme që rregullojnë procedurat e kërkimit shkencor. Kjo do të thotë se edhe në mungesë të një strategjie të gjerë institucionale, ekzistojnë korniza rregullatore operative që mbështesin aktivitetet kërkimore në nivel praktik dhe funksional.

Një aspekt thelbësor i zhvillimit të kërkimit shkencor është mbështetja financiare. Sipas të dhënave, 88.9% e institucioneve deklarojnë se kanë fonde të dedikuara për kërkim shkencor, ndërsa vetëm një përqindje e vogël (11.1%) nuk posedojnë mbështetje të tillë. Megjithatë, vlerat mesatare vjetore të fondeve ndryshojnë dhe nuk janë gjithmonë të përcaktuara qartë. Disa institucione kanë buxhete të konsiderueshme, si 70,000–100,000 euro në vit, ndërsa të tjerët operojnë me fonde shumë modeste (p.sh., 500–6,000 euro). Disa institucione sigurojnë fonde për çdo publikim në varësi të platformës, duke ofruar mbështetje që varion nga 300 deri në 1,200 euro për artikull, dhe të tjerët ndajnë 2–3 grante vjetore për çdo njësi akademike. Kjo tregon një pabarazi të konsiderueshme në kapacitetet financiare midis institucioneve, që mund të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rezultateve kërkimore.

Sa i përket mekanizmave motivues, situata duket po aq pozitive: 88.9% e institucioneve kanë politika specifike për të nxitur kërkimin shkencor, duke përfshirë promovimet akademike, shpërblimet monetare dhe lehtësime të tjera administrative. Avancimi akademik shpesh kushtëzohet drejtpërdrejt nga publikimet në platforma të indeksuara si SCOPUS dhe Web of Science, ndërsa disa institucione ofrojnë çmime speciale si “Hulumtuesi i Vitit”, grante të brendshme ose reduktime të ngarkesës së punës për publikuesit aktivë. Në disa raste përmenden rregullore dhe udhëzime të detajuara lidhur me performancën kërkimore dhe kriteret e financimit, që reflektojnë një nivel të lartë formalizimi të politikave kërkimore.

Ndikimi i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë nga AKA në Institucionet e Arsimit të Lartë

Rezultatet e analizës tregojnë se procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë, i kryer nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA), perceptohet gjerësisht si i dobishëm dhe me ndikim pozitiv në institucionet e arsimit të lartë.

78.9% e institucioneve e konsiderojnë këtë proces “shumë të dobishëm,” ndërsa vetëm një përqindje e vogël (5.3%) shprehin skepticizëm ose e shohin atë si joefektiv. Kjo konfirmon legjitimitetin dhe rëndësinë e këtij

procesi në ndërtimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Institucionet e anketuara i konsiderojnë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm si të dobishme në 100% të rasteve. Përshkrimet e dhëna nga të anketuarit theksojnë se rekomandimet kanë shërbyer si udhëzime për zhvillimin strategjik, përmirësimin e kurrikulave, avancimin e praktikave kërkimore dhe forcimin e menaxhimit institucional. Ato kanë ndihmuar në rritjen e cilësisë akademike, promovimin e bashkëpunimit me industrinë dhe komunitetin, si dhe përmirësimin e përvojës së studentëve. Disa institucione raportuan hapa konkretë të ndërmarrë si rezultat i rekomandimeve, si miratimi i rregulloreve për financimin e punimeve shkencore, themelimi i instituteve kërkimore, lehtësimi i avancimeve akademike dhe rritja e trajnimeve për stafin dhe studentët.

Ndikimi i Vlerësimit të Jashtëm në Kërkimin Shkencor

Një fokus i veçantë i kësaj analize është ndikimi i vlerësimit të jashtëm në zhvillimin e kërkimit shkencor. Sipas të dhënave, 63.2% e institucioneve e konsiderojnë këtë ndikim si “shumë të dobishëm,” ndërsa 31.6% e shohin atë si mesatar. Kjo tregon se ekspertët e AKA-së kanë pasur një rol të rëndësishëm në fuqizimin e kërkimit shkencor si një komponent themelor të cilësisë institucionale.

Në 94.7% të rasteve, raportet e akreditimit kanë përfshirë rekomandime specifike për zhvillimin e kërkimit shkencor. Shembuj konkretë përfshijnë zbatimin e programeve anti-plagjiaturë, rritjen e mbështetjes financiare për kërkim shkencor, përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore, krijimin e platformave për monitorimin e publikimeve dhe fuqizimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Në disa raste, është theksuar rëndësia e botimeve në revista me faktor ndikimi dhe zhvillimi i politikave për transferimin e njohurive në industri.

Institucionet kanë ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta në përgjigje të këtyre rekomandimeve, përfshirë instalimin e programeve anti-plagjiaturë, krijimin e instituteve kërkimore, rritjen e financimit për projekte, organizimin e trajnimeve kërkimore dhe përfshirjen aktive të studentëve në projekte. Disa institucione kanë zhvilluar rregullore të reja

për financimin e publikimeve shkencore, kanë rishikuar strategjitë kërkimore dhe kanë ndërtuar partneritete të reja ndërkombëtare si pjesë të përpjekjeve për të zbatuar rekomandimet.

Sfidat Kryesore në Zhvillimin e Kërkimit Shkencor

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë përballen me një sërë sfidash strukturore, financiare dhe operative që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm të kërkimit shkencor. Mungesa e financimit është raportuar si sfida më e përhapur, e përmendur në pothuajse çdo përgjigje. Institucionet raportojnë se financimi aktual — si në nivel institucional ashtu edhe përmes skemave kombëtare është i pamjaftueshëm për të mbuluar kostot reale të kërkimit shkencor modern, veçanërisht në fusha si inxhinieria, teknologjia, mjekësia ose shkencat laboratorike, ku kërkimi shkencor kërkon pajisje të avancuara, mostra dhe materiale.

Një sfidë tjetër serioze është qasja e kufizuar në revista dhe databaza shkencore të njohura ndërkombëtarisht, veçanërisht Scopus, Web of Science dhe platformat e tjera të indeksimit. Shumë institucione nuk kanë buxhet të mjaftueshëm për abonime apo parapagime, duke i detyruar hulumtuesit të mbështeten në burime të kufizuara ose jo gjithmonë të besueshme. Kjo krijon një hendek midis asaj që kërkohet për akreditim dhe avancim akademik dhe asaj që është realisht e arritshme për stafin akademik.

Gjithashtu, është theksuar mungesa e trajnimeve të avancuara në metodologjinë kërkimore, si dhe mungesa e instituteve, laboratorëve funksionalë dhe infrastrukturës mbështetëse që do të mundësonin zhvillimin e kërkimeve shkencore të thelluara. Kjo ndikon në mungesën e një kulture kërkimore në disa institucione dhe e bën të vështirë zhvillimin e projekteve kërkimore të mirëfillta dhe afatgjata.

Nevoja për Mbështetje dhe Ndërhyrje Institucionale

Shumica e institucioneve kërkojnë mbështetje prioritare nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) (68.4%), si organi përgjegjës për politikat arsimore dhe buxhetin për shkencë. Vetëm një përqindje e vogël (21.1%) kërkojnë ndërhyrje direkte nga AKA,

ndërsa pjesa tjetër i drejtohen institucioneve të tjera shtetërore ose partnerëve ndërkombëtarë.

Sipas analizës së përgjigjjeve, mbështetja specifike e kërkuar për përmirësimin e kërimit shkencor përfshin:

- Rritjen e financimit publik të dedikuar për projekte kërkimore, përfshirë subvencione për publikime dhe pajisje kërkimore.
- Trajnime të avancuara për stafin akademik në fushën e metodologjisë kërkimore, qasje në revista shkencore dhe zhvillimin e projekteve ndërkombëtare.
- Sigurimin e qasjes në databaza shkencore ndërkombëtare dhe abonime në revista me faktor ndikimi të lartë.
- Thjeshtimin e procedurave për marrjen e granteve dhe rekrutimin e stafit kërkimor, duke mundësuar më shumë fleksibilitet administrativ.
- Krijimin e mekanizmave për shpërblimin e rezultateve kërkimore me cilësi të lartë, përfshirë grante për publikime në revista të indeksuara dhe bonuse për bashkëpunime ndërkombëtare.
- Harmonizimin e standardeve dhe rregulloreve mes MASHTI-së dhe AKA-së, veçanërisht në lidhje me klasifikimin e revistave të dyshimta dhe interpretimin e platformave të indeksimit.

Për më tepër, disa institucione kërkojnë mbështetje të veçantë në hartimin e Rregullores për Aktivitete Kërkimore dhe një interpretim të qartë të standardeve të vlerësimit të kërimit shkencor. Ata theksojnë nevojën për një qasje të unifikuar dhe transparente, e cila nxit zhvillimin dhe jo pengimin e saj.

Seksioni IV

Përfundime

Ngjashmëritë dhe Dallimet në Vlerësimin e Fushën e Standardit të Kërkimit Shkencor në Programet Bachelor, Master dhe në Vlerësimet Institucionale

Një analizë krahasuese e raporteve të akreditimit nxjerr në pah një dallim të qartë në mënyrën se si vlerësohet kërkimi shkencor në programet BSc, MSc dhe në nivel institucional. Në programet BSc, vlerësimi i kërkimit shkencor zakonisht fokusohet në përfshirjen minimale të komponentëve kërkimorë në kurrikulë dhe mungesën e temave të diplomës të bazuara në kërkime shkencore. Për shembull, disa programe në nivel Bachelor janë evidentuar për mungesën e moduleve për trajnim në metodologjinë e kërkimit shkencor si dhe për infrastrukturën e pamjaftueshme për mbështetjen e projekteve kërkimore. Nga ana tjetër, programet MSc marrin vlerësime më pozitive, falë përfshirjes së temave të diplomës të bazuara në kërkim shkencor dhe, në disa raste, përfshirjes së studentëve në projekte të mbështetura institucionalisht. Në disa raste, programet MSc janë përshkruar si nxitës të zhvillimit të kapaciteteve kërkimore institucionale.

Ndërsa në vlerësimet institucionale, fokusi zakonisht është mbi nivelin e përgjithshëm të infrastrukturës, numrin total të publikimeve, funksionalitetin e qendrave kërkimore dhe pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare. Si rezultat, një institucion mund të marrë një vlerësim pozitiv në nivel institucional për zhvillimin e laboratorëve të rinj dhe për publikimet e stafit në SCOPUS dhe Web of Science, edhe pse këto elemente mund të mos pasqyrohen në vlerësimin e programeve individuale. Kjo qasje e fragmentuar në vlerësim krijon një mospërputhje sistematike që mund të keqinterpretojë progresin real të institucionit.

Rekomandohet fuqimisht krijimi i një qasjeje të harmonizuar për vlerësimin e fushës së standardit të kërkimit shkencor, duke siguruar që programet BSc, MSc dhe vlerësimet institucionale të udhëhiqen nga tregues të ndërlidhur. Një instrument i unifikuar për monitorimin e aktiviteteve kërkimore mund të ndihmojë në eliminimin e këtyre

mospërputhjeve dhe të sigurojë një proces vlerësimi më të drejtë dhe të bazuar në të dhëna.

Konsistenca me Kalimin e Kohës dhe Zhvillimi i Vlerësimeve

Një shqyrtim më i detajuar i cikleve të akreditimit në periudha të ndryshme kohore tregon një mungesë të konsistencës së plotë në vlerësimin e fushës së standardit të kërkimit shkencor, si në nivel institucional ashtu edhe në nivel të programeve (BSc dhe MSc). Në disa raste, institucione me rezultate të ngjashme në publikime, pjesëmarrje në projekte kërkimore dhe strategji institucionale të kërkimit shkencor kanë marrë vlerësime të ndryshme përgjatë cikleve të akreditimit. Për shembull, një institucion që në vitin 2021 ishte vlerësuar si plotësisht në përputhje falë një strategjie të zhvilluar të kërkimit shkencor dhe një numri të konsiderueshëm publikimesh në Scopus, në ciklin e vitit 2024 mori një vlerësim më të ulët për shkak të mungesës së të dhënave të përditësuara dhe evidencës së publikuar. Kjo nxjerr në pah një sfidë të rëndësishme që lidhet me mekanizmat e mbledhjes dhe interpretimit të të dhënave gjatë vlerësimeve, si dhe me aftësinë e vetë institucioneve për të dokumentuar zhvillimin e qëndrueshëm.

Për të shmangur vlerësimet jokonsistente dhe për të siguruar besueshmëri në të gjitha ciklet e akreditimit, rekomandohet krijimi i një mekanizmi të standardizuar për matjen e progresit, së bashku me një platformë të përbashkët digjitale që dokumenton në mënyrë transparente dhe të verifikueshme zhvillimet dhe evidencat përkatëse.

Roli dhe Përmbajtja e Rekomandimeve nga AKA

Rekomandimet e ofruara nga ekspertët gjatë procesit të akreditimit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në nxitjen e reformave institucionale në fushën e kërkimit shkencor. Megjithatë, analizat tregojnë se përmbajtja e këtyre rekomandimeve nuk ka qenë gjithmonë konsistente apo e sinkronizuar përgjatë cikleve dhe niveleve të akreditimit. Në disa raste, programe të njëjta në nivelet BSc dhe MSc kanë marrë rekomandime të ndryshme për të njëjtën fushë, siç është qasja në revista shkencore apo përfshirja e studentëve në kërkim shkencor. Gjithashtu, në disa

institucione, rekomandimet janë përsëritur pa u theksuar nëse janë adresuar apo jo në ciklin e mëparshëm.

Në anën tjetër, në disa raste, rekomandimet kanë qenë instrumentale në nxitjen e transformimit të brendshëm brenda institucioneve. Për shembull, një rekomandim për krijimin e një platforme për monitorimin e publikimeve shkencore u implementua nga disa institucione, të cilat më pas demonstruan përmirësime në performancën kërkimore dhe transparencën në raportim.

Për të siguruar një ndikim më të madh të rekomandimeve, sugjerohet që AKA të zhvillojë një sistem të unifikuar për ndjekjen e zbatimit të tyre, duke e përfshirë këtë si një komponent të detyrueshëm në raportet pas-akreditimit dhe në raportet vjetore institucionale.

Perceptimi i IAL-ve dhe Roli i AKA-së

Pjesa e tretë e analizës vë në pah mënyrën se si institucionet e arsimit të lartë e perceptojnë rolin e tyre dhe atë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim në nxitjen e kërkimit shkencor.

Të dhënat tregojnë qartë se kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë ka hyrë në një fazë më të strukturuar dhe të qëndrueshme zhvillimi gjatë viteve të fundit. Rritja e numrit të publikimeve në revista me ndikim të lartë, zgjerimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe shtimi i projekteve të financuara janë tregues konkretë të këtij trendi pozitiv. Ky progres nuk është i rastësishëm, por rezultat i drejtpërdrejtë i disa faktorëve të ndërlidhur me politikat e brendshme institucionale dhe kërkesat e jashtme për cilësi dhe përgjegjshmëri akademike.

Një nga faktorët më të rëndësishëm që ka ndikuar në këtë përmirësim ka qenë procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë i zhvilluar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Institucionet e arsimit të lartë e shohin këtë proces si jashtëzakonisht të dobishëm, pasi ka ofruar udhëzime të qarta dhe praktike për zhvillimin strategjik të kërkimit shkencor. Rekomandimet nga ekspertët e jashtëm janë përdorur për të hartuar politika të reja, për të përmirësuar rregulloret ekzistuese dhe për të rritur transparencën në performancën kërkimore. Në shumë raste, janë ndërmarrë hapa konkretë si: instalimi i softuerëve për parandalimin e

plagjiaturës, themelimi i instituteve kërkimore, përfshirja e studentëve në projekte kërkimore dhe ndarja e fondeve të reja për publikime me cilësi të lartë.

Gjithashtu, futja e kriterëve të reja për avancimin akademik, të lidhura ngushtë me performancën kërkimore – në veçanti me publikimet në revista të indeksuara ndërkombëtarisht – ka pasur ndikim të madh. Kjo ka krijuar një presion pozitiv dhe ka rritur motivimin e stafit akademik për t'u angazhuar në kërkime shkencore serioze dhe me ndikim. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare ka hapur gjithashtu mundësi të reja për bashkëpunim, qasje në databaza të rëndësishme dhe burime që më parë ishin të paarritshme.

Megjithatë, përkundër këtij progresi, sfidat mbeten të pranishme. Shumë institucione raportojnë se mungesa e financimit, qasja e kufizuar në databaza shkencore si SCOPUS dhe Web of Science, mungesa e laboratorëve të pajisur mirë dhe trajnimet e pamjaftueshme në metodologjinë e kërkimit pengojnë zhvillimin e mëtejshëm. Kjo krijon dallime të mëdha midis institucioneve me më shumë mundësi dhe atyre që përballen me kufizime të theksuara strukturore dhe financiare.

Në këtë kontekst, mbështetja institucionale nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është thelbësore. Shumica e institucioneve kërkojnë rritje të fondit publik për kërkim shkencor, thjeshtim të procedurave për grante dhe qasje më të lehtë në burime ndërkombëtare. Po ashtu, është e nevojshme një koordinim më i mirë ndërmjet MASHT-it dhe AKA-së, veçanërisht për të unifikuar rregulloret që lidhen me publikimet, platformat e indeksimit dhe vlerësimin e cilësisë së kërkimit shkencor.

Në fund, progresi i arritur deri më tani dëshmon se me politika të qëndrueshme, mbështetje të qartë dhe kërkesa të drejta për cilësi, është e mundur të krijohet një kulturë funksionale e kërkimit shkencor në Kosovë. Megjithatë, për të ruajtur dhe fuqizuar këtë moment pozitiv, kërkohet investim i vazhdueshëm në njerëz, infrastrukturë dhe bashkëpunim institucional. Kërkimi shkencor nuk është një luks – por është një domosdoshmëri për zhvillim, dije dhe ndërtimin e një sistemi arsimor më cilësor dhe më të lidhur me botën.

Aneksi 1: Korniza Metodologjike dhe Shkalla e Përputhshmërisë

Kjo analizë tematike bazohet në raportet e akreditimit dhe reakreditimit për programe dhe institucione të dorëzuara në AKA ndërmjet viteve 2019 dhe 2024. Për qëllime të qartësisë, vendimet e akreditimit në Kosovë lëshohen veçmas për secilin program, lokacion, formë të ofrimit dhe gjuhë të mësimdhënies. Secili prej këtyre trajtohet si një rast i veçantë, gjë që shpjegon pse i njëjti institucion mund të paraqitet disa herë në të dhënat e analizës.

Standardet që lidhen me Kërkimin Shkencor

Analiza fokusohet në Fushën e Standardit për Kërkim (Research Standard) brenda Manualit të Akreditimit të AKA-së. Gjatë vlerësimit të vitit 2019, panelet e ekspertëve kanë dhënë nivele të përgjithshme të përputhshmërisë, pa caktuar nota për indikatorët. Në ciklet e mëvonshme (2021, 2022, 2024), përputhshmëria është vlerësuar në nivel të indikatorëve, duke mundësuar krahasim më të detajuar. Për të mundësuar analizë të vazhdueshme në kohë, notat për indikatorët në vitin 2019 janë rikonstruktuar në bazë të përmbajtjes narrative dhe rekomandimeve të paneleve të ekspertëve.

Shkalla e Përshtatshmërisë e Zbatuar nga AKA

Të gjitha vlerësimet programore dhe institucionale zbatojnë shkallën katër-niveçare të përputhshmërisë të AKA-së:

- **Plotësisht në përputhje (A):** Të gjitha kërkesat janë përmbushur.
- **Substancialisht në përputhje (B):** Shumica e kërkesave janë përmbushur; nevojiten vetëm përmirësime të vogla.
- **Pjesërisht në përputhje (C):** Kërkesa të rëndësishme mungojnë; nevojiten përmirësime të mëdha.
- **Jo në përputhje (D):** Kërkesat nuk janë përmbushur; nuk është arritur pragu minimal.

Aneksi 2: Fusha e Standardit për Kërkim Shkencor në Nivel Programor dhe Institucional

Niveli Programor (BSc/MSc)

Standardi 6: Kërkimi Shkencor

6.1 Programi studimor ka objektiva të përcaktuara për kërkimin shkencor/aplikativ (në mënyrë të pavarur ose si pjesë e një qendre kërkimore apo programi ndërdisiplinor), të cilat pasqyrohen edhe në planin e zhvillimit kërkimor të institucionit; janë alokuar burime të mjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore për arritjen e këtyre objektivave.

6.2 Pritjet për përfshirjen e stafit akademik në aktivitete kërkimore dhe shkencore janë të përcaktuara qartë, dhe performanca në raport me këto pritje merret parasysh në vlerësimin dhe avancimin e stafit.

6.3 Janë përcaktuar politika të qarta për definimin e asaj që konsiderohet si kërkim shkencor, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat e fushës përkatëse të studimit.

6.4 Stafi akademik ka dëshmi të rezultateve kërkimore në të njëjtat tema me ato që ligjëron.

6.5 Stafi akademik dhe kërkimor publikon punimet e tyre në revista të specializuara apo shtëpi botuese, produktet shkencore/aplikative/artistike prezantohen në konferenca, sesione, simpoziume, seminare, etj., si dhe ofrohen kontrata, ekspertizë, konsulencë, marrëveshje, etj., për partnerë brenda dhe/ose jashtë vendit.

6.6 Kërkimi shkencor validitetin e tij e arrin përmes: publikimeve shkencore dhe aplikative, produkteve artistike, transferit të teknologjisë përmes qendrave të konsulencës, parqeve shkencore dhe strukturave të tjera për validim.

6.7 Çdo anëtar i stafit akademik dhe kërkimor ka prodhuar mesatarisht të paktën një publikim kërkimi shkencor/aplikativ ose rezultat artistik për çdo vit gjatë tre viteve të fundit.

6.8 Stafi akademik dhe kërkimor publikon punimet nën emrin e institucionit në Kosovë me të cilin është i punësuar me orar të plotë.

6.9 Janë krijuar politika për pronësinë intelektuale dhe janë përcaktuar procedura të qarta për komercializimin e ideve të zhvilluara nga stafi dhe studentët.

6.10 Studentët janë të përfshirë në projekte dhe aktivitete kërkimore.

Niveli Institucional (IAL)

Fusha - Standardi 6: Kërkimi Shkencor

6.1 Institucioni i arsimit të lartë ka përcaktuar objektiva për kërkimin shkencor/aplikativ në përputhje me misionin dhe planin strategjik të zhvillimit, të mbështetur me burime të mjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore.

6.2 Politikat dhe pritjet për përfshirjen e stafit në aktivitete kërkimore dhe shkencore janë të përcaktuara qartë dhe të integruara sistematikisht në vlerësimin dhe avancimin e stafit.

6.3 Institucioni ka politika të qarta për definimin dhe njohjen e kërkimit shkencor, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat disiplinore.

6.4 Institucioni demonstroi një histori të qëndrueshme të rezultateve kërkimore nëpër fakultete dhe departamente, me aktivitete kërkimore të lidhura me portofolin mësimor.

6.5 Stafi akademik dhe kërkimor publikojnë dhe shpërndajnë në mënyrë aktive punën e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes konferencave, revistave shkencore me rishikim kolegjial dhe produkteve hulumtuese apo artistike.

6.6 Institucioni ofron mekanizma për validimin e kërkimit shkencor, përfshirë rishikimin kolegjial, publikimin, transferin e teknologjisë, qendrat e konsulencës dhe partneritetet me parqe shkencore apo struktura të tjera përkatëse.

6.7 Institucioni siguron që stafi akademik prodhon të paktën një publikim ose rezultat të barasvlefshëm kërkimor për çdo vit, në mesatare për të gjithë stafin.

6.8 Stafi publikon në mënyrë të qëndrueshme nën emrin e institucionit, duke forcuar dukshmërinë dhe reputacionin ndërkombëtar.

6.9 Institucioni ka të vendosura rregullore për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe siguron procedura të qarta për komercializimin e rezultateve kërkimore.

6.10 Institucioni përfshin sistematikisht studentët në projekte kërkimore dhe krijon mundësi për pjesëmarrjen e tyre në komunitetin akademik kërkimor.

Aneksi 3: Modeli i Pyetësorit për IAL-të

Pyetësor për Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)
Qëllimi: Të mblidhen të dhëna mbi aktivitetet kërkimore dhe ndikimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në zhvillimin e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.
SEKSIONI 1: Informata të Përgjithshme
Emri i institucionit: _____
Lloji i institucionit: ☐ Publik ☐ Privat
Personi kontaktues dhe pozita: _____
SEKSIONI 2: Të Dhëna për Publikimet Shkencore
Ju lutemi plotësoni numrin e publikimeve shkencore për secilin vit akademik në tabelën më poshtë:

Viti Akademik	Publikime gjithsej	Me bashkautorë ndërkombëtarë	Me financim (grante)	Në revista me faktor ndikimi
2021–2022				
2022–2023				
2023–2024				

A ka pasur rritje të publikimeve në vitet e fundit? ☐ Po ☐ Jo ☐ Ka mbetur e njëjtë
Nëse po, cilët faktorë kanë ndikuar në këtë rritje?

(p.sh. politikat e brendshme, kriteret e AKA-së, përfshirja në projekte ndërkombëtare, avancimi akademik, etj.)
Nëse ka pasur rënie ose stagnim, cilat janë arsyt kryesore?
Në cilat platforma janë publikuar këto publikime? (shënoni me ✓ të gjitha që aplikohen): ☐ Scopus ☐ Web of Science ☐ Google Scholar ☐ Academia.edu ☐ ResearchGate ☐ Tjera
Në cilat fusha shkencore janë përqendruar këto publikime? (p.sh. Shkenca Natyrore, Inxhinieri, Mjekësi, Shkenca Shoqërore, Ekonomi, Arte, etj.)
SEKSIONI 3: Mbështetja Institucionale për Kërkimin shkencor
A ka institucioni strategji të brendshme për zhvillimin e kërkimit shkencor? ☐ Po ☐ Jo
A posedoni dokument/rregullore për procedurat e kërkimit? ☐ Po ☐ Jo
A ka institucioni fonde të dedikuara për kërkim shkencor? ☐ Po ☐ Jo Nëse po, cila është vlera mesatare vjetore? _____
A ekzistojnë mekanizma për të inkurajuar publikimin (p.sh. shpërblime, avancime akademike, etj.)?
SEKSIONI 4: Ndikimi i Procesit të Akreditimit
Si e vlerësoni ndikimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë (nga AKA) në institucionin tuaj? ☐ Shumë i dobishëm ☐ Mesatar ☐ I ulët ☐ Aspak i dobishëm

A i konsideroni të dobishme rekomandimet e ekspertëve për institucionin tuaj? Nëse po, përshkruani:
Si e vlerësoni ndikimin e vlerësimit të jashtëm (nga AKA) në përmirësimin e kërimit shkencor në institucionin tuaj? ☐ Shumë të lartë ☐ Mesatar ☐ Të ulët ☐ Aspak të lartë
A janë përfshirë rekomandime për kërkimin shkencor në raportet e akreditimit institucional/programor në vitet e fundit? ☐ Po ☐ Jo Nëse po, jepni një shembull:
A janë ndërmarrë veprime për të përmirësuar kërkimin shkencor në përgjigje të këtyre rekomandimeve? ☐ Po ☐ Jo Nëse po, specifikoni:
SEKSIONI 5: Sfidat dhe Nevojat
Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballlet institucioni juaj në zhvillimin e kërimit shkencor? (p.sh. mungesa e fondeve, qasje në revista, mungesë trajnimesh, etj.)
Nga cili institucion kërkon mbështetje? ☐ AKA ☐ MASHTI ☐ Tjetër
Çfarë mbështetje konkrete do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin dhe zhvillimin e kërimit?